FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 29

Tiranë – E hënë, 9 shkurt 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 4, datë 30.1.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014, "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar.....	2471
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 72, datë 23.1.2026	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 249, datë 13.3.2025, "Për ngarkim të përkohshëm/zëvendësim në detyrë"	2475
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 86, datë 28.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar.....	2475
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 87, datë 28.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë....	2478
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 88, datë 29.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.	2479
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 89, datë 29.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	2480
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 90, datë 29.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Maqedonisë së Veriut.....	2481
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 91, datë 29.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	2482

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 92, datë 30.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.	2483
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 93, datë 30.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	2485
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 94, datë 30.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë....	2487
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 27, datë 29.1.2026	Mbi miratimin e rregullores "Për koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në fushën e formimit profesional të administratës gjyqësore dhe të prokurorisë"	2488
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 4, datë 15.1.2026	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	2490
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 5, datë 15.1.2026	Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "SunPro" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	2492
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 6, datë 15.1.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	2494
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 7, datë 15.1.2026	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	2495
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 8, datë 15.1.2026	Mbi fillimin e procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë "INFO-telecom" sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	2496
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 9, datë 15.1.2026	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë "Green Plus Energy" sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj "ProCredit Bank" sh.a.....	2497
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 10, datë 15.1.2026	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Age Erzen" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	2499
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 11, datë 15.1.2026	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 262, datë 21.10.2025, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Vivid Power' sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike".....	2500
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 12, datë 15.1.2026	Mbi disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 234, datë 5.11.2024, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Delta Plan Studio' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	2502

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 13, datë 15.1.2026	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 262, datë 2.12.2024, "Mbi licencimin e shoqërisë 'SLR Albania' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike", i ndryshuar.....	2503
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 14, datë 15.1.2026	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, "Mbi licencimin e shoqërisë 'EB Energy' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike", i ndryshuar.....	2505
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 15, datë 15.1.2026	Mbi përcaktimin e vlerës së detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026.....	2506
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 48/7, datë 2.2.2026	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerim i segmentit rrugor dalje Elbasan–Përrenjas–Qafëthanë, faza II".....	2508

UDHËZIM
Nr. 4, datë 30.1.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 3.11.2014, "PËR ZBATIMIN E REGJIMIT TË VEÇANTË TË SKEMËS SË KOMPENSIMIT TË PRODHUESVE BUJQËSORË PËR QËLLIME TË TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 159, paragrafi 2, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014, "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 3 "Kushte të përgjithshme", pas pikës 1, shtohen pikat 1.1 dhe 1.2 me përmbajtjen si më poshtë:

"1.1 Personi i tatueshëm, blerës i produkteve bujqësore është personi i regjistruar për TVSH-në, i cili ushtron aktivitet si grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për turizmin.

1.2 Për qëllime të këtij udhëzimi, blerësit e produkteve bujqësore, referuar pikës 1.1 të këtij neni, kanë kuptimin si më poshtë:

a)"Grumbullues i produkteve bujqësore" është personi fizik ose juridik, i regjistruar me përgjegjësi tatimore për TVSH-në, i cili ushtron veprimtari ekonomike, sipas kodeve të aneksit 1 bashkëlidhur, të blerjes, mbledhjes, selektimit dhe tregtimit me shumicë, të produkteve bujqësore dhe/ose blegtorale, me prejardhje nga puna e fermerit, të furnizuara drejtpërdrejt prej tij;

b)"Përpunues i produkteve bujqësore" është personi fizik ose juridik, i regjistruar me përgjegjësi tatimore për TVSH-në, i cili ushtron veprimtari ekonomike, sipas kodeve të aneksit 1 bashkëlidhur, të blerjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe/ose blegtorale, me prejardhje nga puna e fermerit, të furnizuara drejtpërdrejt prej tij;

c) "Agroturizëm i certifikuar" ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për turizmin, ku personi i tatueshëm që ushtron këtë aktivitet blen produkte bujqësore dhe/ose blegtorale, me prejardhje nga puna e fermerit, të furnizuara drejtpërdrejt prej tij.".

Neni 2

Në nenin 4 "Kushtet për të përfituar nga skema e kompensimit", pika 1, riformulohet me përmbajtjen si më poshtë:

"Fermeri përfiton të drejtën e kompensimit për sa kohë që qarkullimi vjetor i tij nuk tejkalon kufirin minimal të përcaktuar të regjistrimit për TVSH-në. Ky qarkullim bazohet në shitjet e kryera, sipas vlerës totale të furnizimit të shënuar në faturë, për produktet bujqësore, kundrejt personave të tatueshëm që nuk përfitojnë nga skema e kompensimit, të regjistruar për TVSH-në që ushtrojnë aktivitet si grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm i certifikuar.".

Neni 3

Në pikën 2, të nenit 7 "Çregjistrimi i fermerit", shfuqizohet fjalia e fundit me përmbajtje: "Personi i tatueshëm që ka përfituar zbritjen e TVSH-së së shënuar në faturën e lëshuar në emrin dhe për llogari të fermerit të çregjistruar, pas datës që çregjistrimi i tij ka hyrë në fuqi, nuk i lejohet të zbresë TVSH-në përkatëse dhe ndërkohë nëse e ka zbritur atë TVSH në shkelje të procedurës, i kërkohet të paguajë 100% TVSH-në e zbritur padrejtësisht.".

Neni 4

Neni 8 "Mënyra e zbatimit të skemës se kompensimit" ndryshon me përmbajtjen si më poshtë:

"Neni 8
Mënyra e zbatimit të skemës së kompensimit

1. Blerësi, person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në, për çdo furnizim të produkteve

bujqësore, të marrë prej fermerit, në përputhje me këtë udhëzim, lëshon një faturë tatimore të fiskalizuar, në përputhje me ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, në të cilën evidenton si shitës, shitësin fermer (prodhues bujqësor), NIPT-in e fermerit dhe të dhënat e tjera të kërkuara sipas faturës. Kjo faturë, në të cilën nuk llogaritet TVSH-ja, lëshohet nga blerësi në momentin e dorëzimit të produkteve bujqësore nga fermeri.

2. Vlera e faturës përfaqëson vlerën e furnizimit të paguar nga blerësi për llogari të shitësit fermer, mbi të cilën aplikohet norma e kompensimit. Kjo vlerë e faturës regjistrohet nga blerësi i produkteve bujqësore në rubrikën e librit të blerjeve "Nga fermerët vendas/vlera e tatueshme". Rubrika e librit të blerjeve "Nga fermerët vendas/TVSH" nuk plotësohet, pasi kompensimi i jepet fermerit nga administrata tatimore dhe jo nga blerësi.

3. Kërkesa për kompensim paraqitet sipas periudhave të mëposhtme:

a) brenda datës 31 dhjetor, për furnizimet e kryera gjatë periudhës janar–qershor të vitit përkatës;

b) brenda datës 30 qershor të vitit pasardhës, për furnizimet e kryera gjatë periudhës korrik–dhjetor të vitit paraardhës.

4. Fermeri, nëpërmjet shërbimit postar ose në rrugë elektronike, dorëzon në administratën tatimore kërkesën për kompensim, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Kërkesa, ndër të tjera, duhet të përmbajë vlerën totale të faturave të lëshuara përgjatë periudhës së kompensimit, si dhe numrin e llogarisë bankare të fermerit. Kjo kërkesë shoqërohet edhe me kopje të faturave të lëshuara nga blerësi, sipas nenit 9 të këtij udhëzimi, të cilat duhet të jenë të firmosura nga shitësi-fermer.

5. Për të përfituar kompensimin, kushtet që duhet të plotësojë fermeri janë:

a) qarkullimi vjetor nuk tejkalon kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) të ketë kryer furnizime të produkteve bujqësore, sipas nenit 2 të këtij udhëzimi;

c) të ketë furnizuar persona të tatueshëm që nuk përfitojnë nga skema e kompensimit në Republikën e Shqipërisë, të cilët janë të regjistruar për TVSH-në dhe ushtrojnë aktivitet si grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për turizmin;

d) është pajisur me një numër identifikimi të personit të tatueshëm, sipas nenit 5 të këtij udhëzimi;

e) faturat e marra nga blerësi, mbi bazën e së cilave kërkohet kompensimi janë të fiskalizuara dhe regjistruara në bazën e të dhënave të administratës tatimore qendrore.

6. Norma e kompensimit në masën 10% zbatohet mbi vlerën e faturës/ave tatimore që blerësi, person i tatueshëm i ka lëshuar shitësit, prodhues bujqësor, përgjatë periudhës gjashtëmujore, për të cilën kërkohet kompensimi.

7. Kompensimi ka për qëllim të mbulojë një pjesë të TVSH-së së paguar prej fermerëve në çmimin e blerjes së mallrave e shërbimeve, të blera për nevoja të kryerjes së aktivitetit të tyre prodhues bujqësor.

8. Pas marrjes së kërkesës për kompensim, administrata tatimore shqyrton kërkesën, kontrollon dhe vlerëson dokumentet bashkëlidhur, për të përcaktuar nëse fermeri i plotëson kushtet për përfitimin e kompensimit apo jo. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, administrata tatimore njofton menjëherë fermerin për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10-(dhjetë-)-ditor.

Administrata tatimore, krahas verifikimit të faturave të lëshuara nga blerësi, sipas nenit 9 të këtij udhëzimi dhe të firmosura nga shitësi-fermer, verifikon edhe nëse blerësi i produkteve bujqësore është person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në që ushtron aktivitet si grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm i certifikuar, sipas kuptimit në nenin 3 të këtij udhëzimi. Gjithashtu, ajo verifikon përputh-shmërinë e vlerës së produkteve bujqësore sipas faturave të dorëzuara nga fermeri me vlerën e faturave të fiskalizuara dhe deklaruara nga blerësi në bazën e të dhënave të administratës tatimore qendrore.

9. Nëse pas verifikimeve, rezulton se janë përmbushur kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në ligj dhe në këtë udhëzim, administrata tatimore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, paguan shumën e kompensimit direkt në llogarinë bankare të fermerit. Shuma që do të kompensohet është rezultat i shumëzimit të normës së kompensimit me vlerën totale të furnizimit të produkteve bujqësore, të kryer në periudhën përkatëse.".

Neni 5

Neni 9 "E drejta e zbritjes së TVSH-së së kompensuar" shfuqizohet.

Neni 6

Neni 10 "Fatura tatimore dhe norma e kompensimit" numërtohet neni 9 dhe ndryshon me përmbajtjen, si më poshtë:

"Neni 9

Fatura tatimore dhe norma e kompensimit

1. Fatura duhet të përmbajë dhe të plotësohet me të gjitha të dhënat e kërkuara sipas rubrikave përkatëse. Në çdo faturë të lëshuar nga blerësi, person i tatueshëm, duhet të evidentohet shënimi "Vetëfaturim sipas skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë".

2. Fatura tatimore e fiskalizuar e shitjes, e lëshuar nga personi i tatueshëm blerës për prodhuesin bujqësor (fermerin), duhet detyrimisht të përmbajë të shënuara të dhënat e mëposhtme:

i. numri i faturës;

ii. numri i sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF);

iii. numri identifikues i veçantë i faturës (NIVF);

iv. data dhe ora e lëshimit të faturës;

v. numri rendor që mundëson identifikimin e faturës;

vi. të dhënat e fermerit, si: emri, adresa ku ka veprimtarinë prodhuese, NIPT-i;

vii. të dhënat e blerësit, personit të tatueshëm, si: emri, adresa, kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë, NIPT-i;

viii. përshkrimi, sasia dhe njësia matëse e mallrave;

ix. vlera e mallrave të blera pa TVSH.

3. Në rastin kur blerësi, personi i tatueshëm paraqitet në adresën e fermerit dhe transporton mallrat me mjetet e tij nga adresa e fermerit në adresën ku blerësi kryen veprimtarinë ekonomike, atëherë fatura tatimore i lëshohet fermerit nga blerësi në momentin që malli bëhet i disponueshëm prej blerësit dhe fatura shoqëron mallin në adresën e blerësit. Në këtë rast në faturë shënohen edhe të dhënat e transportuesit.".

Neni 7

Neni 11 "Deklarimi" shfuqizohet.

Neni 8

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

KËRKESË PËR KOMPENSIM TË TVSH-së

Emri dhe mbiemri i fermerit:	
NIPT-i:	
Adresa:	
Numri i telefonit:	

Kërkoj shumën e kompensimit të TVSH-së, në zbatim të seksionit 4, kreu XI, të ligjit nr. 92/2014, i ndryshuar dhe udhëzimit të ministrit të Financave nr. 19, datë 3.11.2014, i ndryshuar.

Vlera totale e furnizimit të produkteve bujqësore, të kryer në:	**Norma e kompensimit**	**Shuma e kompensimit**	**Numri i llogarisë bankare:**
Periudha: _____/viti____	**10%**	**Shuma e kërkuar në lekë**	_____ _____ _____
1	2	3= (1x2)	

_____ **(Nënshkrimi i fermerit)**

_____ **(data)**

ANEKS 1
LISTA E KODEVE TË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE PËRFITUESE TË SKEMËS SË KOMPENSIMIT

1. Kultura bujqësore:

a) bujqësia e përgjithshme, përfshirë vreshtarinë;

b) pemëtaria (përfshirë olivokulturën) dhe hortikultura (perimet, lulet dhe bimët zbukuruese), edhe në serra;

c) prodhimi i kërpudhave dhe i erëzave, i farërave dhe filizave;

ç) prodhimi i fidanëve.

Nr.	Përshkrimi	Kodi
1	Kultivimi i drithërave (përveç orizit), të bimëve bishtajore dhe farërave vajore	A111
2	Kultivimi i orizit	A112
3	Kultivimi i perimeve dhe pjepër e shalqi, rrënjore dhe tuberozë	A113
4	Kultivimi i duhanit	A115
5	Kultivimi i bimëve fibroze	A116
6	Kultivimi i bimëve të tjera joshumëvjeçare	A119
7	Kultivimi i hardhive	A121
8	Kultivimi i agrumeve	A123
9	Kultivimi i frutave me bërthame dhe frutave me farë	A124
10	Rritja e të tjera pemëve e shkurreve frutore dhe e frutave te thata	A125
11	Rritja e frutave vajore	A126
12	Kultivimi i kulturave për pije	A127
13	Kultivimi i erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore	A128
14	Kultivimi i bimëve të tjera shumëvjeçare	A129
15	Shumimi i bimëve	A130
16	Ferma mikse	A150
17	Aktivitete ndihmëse për prodhimin bimor	A161
18	Përpunimi i farërave për shumim	A164
19	Mbledhja e produkteve pyjore të egra jodrusore rritur në natyrë	A230
20	Tregtia me shumicë e drithërave, duhanit të papërpunuar, farërave dhe ushqimit të kafshëve	G4621
21	Tregtia me shumicë e luleve dhe bimëve	G4622
22	Tregtia me shumicë e kafshëve	G4623
23	Tregtia me shumicë e frutave dhe perimeve	G4631
24	Tregtia me shumicë e produkteve të duhanit	G4635
25	Tregtia me shumicë e kafes, çajit, kakaos dhe erëzave	G4637
26	Tregtia me shumicë jo e specializuar e artikujve ushqimorë, pije dhe duhan	G4639
27	Tregtia me shumicë e produkteve të tjera ndërmjetëse	G4676
28	Tregtia me shumicë jo e specializuar	G4690
29	Përpunimi i lëngut të frutave dhe perimeve	C1032
30	Procese të tjera përpunimi dhe konservimi të frutave dhe perimeve	C1039
31	Përpunimi i produkteve të drithërave	C1061
32	Prodhimi i bukës, prodhimi pastave të freskëta dhe kekëve	C1071
33	Distilimi, rektifikimi dhe kombinimi i pijeve	C1101
34	Prodhimi i verës nga rrushi	C1102
35	Prodhimi i mushtit dhe verërave të tjera me bazë frutash	C1103
36	Prodhimi i birrës	C1105
37	Prodhimin e pijeve të tavolinës, prodhimi i ujit mineral dhe ujërave të tjerë në shishe	C1107
38	Përpunimi i vajrave esenciale	C2053
39	Prodhimi i produkteve të tjera ushqimore p.k.t	C1089

2. Blegtoria:

a) mbarështimi i kafshëve;

b) mbarështimi i shpendëve;

c) mbarështimi i lepujve;

ç) mbarështimi i bletëve;
d) mbarështimi i krimbit të mëndafshit;
dh) mbarështimi i kërmillit.

Nr.	Përshkrimi	Kodi
1	Rritja e gjedhëve për qumësht	A141
2	Rritja e të tjera gjedhëve dhe buall	A142
3	Rritja e kuajve dhe njëthundrakëve	A143
4	Rritja e dhenve dhe dhive	A145
5	Rritja e derrave	A146
6	Rritja e shpendëve	A147
7	Rritja e kafshëve të tjera	A149
8	Tregtia me shumicë e mishit dhe produkteve të mishit	G4632
9	Tregtia me shumicë e produkteve bulmetore, vezëve, dhe vajit të gatimit dhe yndyrnave	G4633
10	Prodhimi dhe përpunimi i mishit	C1011
11	Prodhimi i produkteve të mishit dhe mishit të shpendëve	C1013
12	Përpunimi i produkteve të qumështit	C1051
13	Përpunimi i vajrave dhe yndyrnave	C1041
14	Aktivitete ndihmëse për prodhimet blegtorale	A162

URDHËR
Nr. 72, datë 23.1.2026

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 249, DATË 13.3.2025, "PËR NGARKIM TË PËRKOHSHËM/ZËVENDËSIM NË DETYRË"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 249, datë 13.3.2025, "Për ngarkim të përkohshëm/ zëvendësim në detyrë".
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 86, datë 28.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË MBRETËRINË E BASHKUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;
b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.
2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
England	Barnsley	Barnsley*
England	Bath and North East Somerset	Bath and North East Somerset*

England	Buckinghamshire	Buckinghamshire*
England	Bournemouth, Christchurch and Poole	Bournemouth, Christchurch and Poole*
England	Bracknell Forest	Bracknell Forest*
England	Bradford	Bradford*
England	Calderdale	Calderdale*
England	Cambridgeshire	East Cambridgeshire*
England	Cambridgeshire	South Cambridgeshire*
England	Central Bedfordshire	Central Bedfordshire*
England	Cheshire East	Cheshire East*
England	Cheshire West and Chester	Cheshire West and Chester*
England	Cornwall	Cornwall*
England	Derbyshire	Amber Valley*
England	Derbyshire	Bolsover*
England	Derbyshire	Derbyshire Dales*
England	Derbyshire	High Peak*
England	Derbyshire	North East Derbyshire*
England	Devon	East Devon*
England	Devon	Mid Devon*
England	Devon	Teignbridge*
England	Devon	South Hams*
England	Devon	West Devon*
England	Dorset	Dorset*
England	Gloucestershire	Stroud*
England	East Riding of Yorkshire	East Riding of Yorkshire*
England	East Sussex	Rother*
England	East Sussex	Lewes*
England	East Sussex	Wealden*
England	Essex	Braintree*
England	Essex	Brentwood*
England	Essex	Chelmsford*
England	Essex	Colchester*
England	Essex	Epping Forest*
England	Essex	Maldon*
England	Essex	Harlow*
England	Essex	Tendring*
England	Greater London	Harrow*
England	Herefordshire, County of	Herefordshire, County of*
England	Hertfordshire	Dacorum*
England	Hertfordshire	East Hertfordshire*
England	Hertfordshire	Hertsmere*
England	Hertfordshire	Three Rivers*
England	Medway	Medway*
England	Milton Keynes	Milton Keynes*
England	Shropshire	Shropshire*
England	Kent	Ashford*
England	Kent	Canterbury*
England	Kent	Dover*
England	Kent	Gravesham*
England	Kent	Folkestone and Hythe*
England	Kent	Maidstone*
England	Kent	Sevenoaks*
England	Kent	Swale*
England	Kent	Tonbridge and Malling*
England	Kent	Tunbridge Wells*
England	Kirklees	Kirklees*
England	Isle of Wight	Isle of Wight*
England	Somerset	Somerset Council*
England	Suffolk	East Suffolk*
England	Suffolk	Babergh*
England	Suffolk	Mid Suffolk*
England	Suffolk	Waverley*
England	Suffolk	West Suffolk*
England	Surrey	Guildford*
England	Surrey	Runnymede*
England	Hampshire	Basingstoke and Deane*
England	Hampshire	East Hampshire*
England	Hampshire	Eastleigh*
England	Hampshire	Hart*
England	Hampshire	Test Valley*
England	Hampshire	New Forest*
England	Hampshire	Winchester*
England	Lancashire	Chorley*
England	Lancashire	Lancaster*
England	Lancashire	Ribble Valley*
England	Leicestershire	Charnwood*
England	Leicestershire	Harborough*
England	Leicestershire	Hinckley and Bosworth*
England	Leicestershire	North West Leicestershire*
England	Lincolnshire	East Lindsey*
England	Lincolnshire	West Lindsey*
England	Lincolnshire	South Kesteven*
England	Staffordshire	East Staffordshire*
England	Staffordshire	Stafford*
England	Staffordshire	Staffordshire Moorlands*
England	Staffordshire	South Staffordshire*
England	Southampton	Southampton*
England	South Gloucestershire	South Gloucestershire*
England	Stockport	Stockport*
England	Norfolk	Breckland*
England	Norfolk	Broadland*
England	Norfolk	Great Yarmouth*
England	Norfolk	King's Lynn and West Norfolk*
England	Norfolk	South Norfolk*
England	Norfolk	North Norfolk*
England	North Yorkshire	North Yorkshire Council*
England	Nottinghamshire	Bassetlaw*
England	Oxfordshire	South Oxfordshire*
England	Oxfordshire	Vale of White Horse*
England	Tameside	Tameside*
England	Trafford	Trafford*
England	Thurrock	Thurrock*
England	York	York*
England	West Berkshire	West Berkshire*
England	Wiltshire	Wiltshire*
England	Wokingham	Wokingham*
England	Westmorland and Furness Council	Westmorland and Furness Council*
England	West Sussex	Arun*
England	West Sussex	Chichester*
England	West Sussex	Horsham*
Isle of Man	**Middle**	**Braddan***
Jersey	Saint Berlade	Saint Berlade*
Jersey	Saint John	Saint John*
Jersey	Saint Martin	Saint Martin*
Jersey	Saint Peter	Saint Peter*
Jersey	Saint Saviour	Saint Saviour*
United Kingdom Exclusive Economic Zone	Brightlingsea*	
United Kingdom Exclusive Economic Zone	Middleton*	
Wales	Monmouthshire	Monmouthshire*
Wales	Powys	Powys*
Wales	Wrexham	Wrexham*
Northern Ireland	North Down and Ards	Ards*
Northern Ireland	Ards and North Down	North Down*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) Janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 34, datë 12.1.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 87, datë 28.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
b) zogjve 24-orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1.	Csongrád-Csanád	Szentes*
2.	Nógrád	Balassagyarmat*
3.	**Békés**	**Orosháza***
4.	**Békés**	**Szarvas***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 45, datë 13.1.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 88, datë 29.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Neuhardenberg*
2.	Bayern	Dingolfing-Landau	Simbach*
3.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Krempermarsch*
4.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Schenefeld*
5.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
6.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Ludwigslust-Land*
7.	Nordrhein-Westfalen	Paderborn	Delbrück*
8.	Nordrhein-Westfalen	Recklinghausen	Dorsten*
9.	Thüringen	Greiz	Zeulenroda-Triebes*
10.	Schleswig-Holstein	Plön	Lütjenburg*
11.	Niedersachsen	Cloppenburg	Garrel*
12.	Niedersachsen	Diepholz	Stuhr*
13.	Brandenburg	Potsdam-Mittelmark	Beetzsee*
14.	Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Röbel-Müritz*
15.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Torgelow-Ferdinandshof*
16.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen*
17.	Brandenburg	Oberhavel	Kremmen*
18.	Baden-Württemberg	Alb-Donau-Kreis	Langenau*
19.	Niedersachsen	Cloppenburg	Bösel*
20.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Geldern*
21.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Goch*
22.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Rees*
23.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kevelaer*
24.	Niedersachsen	Vechta	Vechta*
25.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Barnim-Oderbruch*
26.	Brandenburg	Prignitz	Plattenburg*
27.	Niedersachsen	Diepholz	Barnstorf*
28.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Föhr-Amrum*
29.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Sylt*
30.	Niedersachsen	Emsland	Geeste*
31.	Niedersachsen	Stade	Fredenbeck*
32.	Niedersachsen	Harburg	Tostedt*
33.	Niedersachsen	Oldenburg	Ganderkesee*
34.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Peenetal/Loitz*
35.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Letschin*
36.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Wriezen*
37.	Hessen	Wetteraukreis	Rockenberg*
38.	Niedersachsen	Cloppenburg	Friesoythe*
39.	Brandenburg	Uckermark	Lychen*
40.	Nordrhein-Westfalen	Wesel	Kamp-Lintfort*
41.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Selsingen*
42.	Niedersachsen	Vechta	Goldenstedt*
43.	Thüringen	Nordhausen	Ellrich*
44.	Sachsen-Anhalt	Mansfeld-Südharz	Goldene Aue*
45.	Niedersachsen	Emsland	Lengerich*
46.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Bremervörde*
47.	Niedersachsen	Stade	Oldendorf-Himmelpforten*
48.	Niedersachsen	Oldenburg	Harpstedt*
49.	Niedersachsen	Diepholz	Altes Amt Lemförde*
50.	Niedersachsen	Diepholz	Rehden*
51.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Miltzow*
52.	Sachsen	Meißen	Ebersbach*

53.	Bayern	Straubing-Bogen	Geiselhöring*
54.	Nordrhein-Westfalen	Rhein-Erft-Kreis	Hürth*
55.	Niedersachsen	Verden	Thedinghausen*
56.	Niedersachsen	Oldenburg	Großenkneten*
57.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Rietberg*
58.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Verl*
59.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Trave-Land*
60.	Niedersachsen	Grafschaft Bentheim	Wietmarschen*
61.	Nordrhein-Westfalen	Coesfeld	Lüdinghausen*
62.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kleve*
63.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Leezen*
64.	Niedersachsen	Oldenburg	Dötlingen*
65.	Sachsen-Anhalt	Anhalt-Bitterfeld	Zerbst/Anhalt*
66.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Versmold*
67.	Schleswig-Holstein	Ostholstein	Fehmarn*
68.	Niedersachsen	Aurich	Dornum*
69.	Nordrhein-Westfalen	Viersen	Kempen*
70.	Niedersachsen	Cloppenburg	Saterland*
71.	Niedersachsen	Osnabrück	Ostercappeln*
72.	Sachsen	Leipzig	Grimma*
73.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Recknitz-Trebeltal*
74.	Sachsen-Anhalt	Altmarkkreis Salzwedel	Gardelegen*
75.	Niedersachsen	Emsland	Haselünne*
76.	Brandenburg	Havelland	Ketzin/Havel*
77.	Baden-Württemberg	Schwarzwald-Baar-Kreis	Donaueschingen*
78.	Sachsen	Nordsachsen	Wermsdorf*
79.	Nordrhein-Westfalen	Hamm	Hamm*
80.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Sottrum*
81.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Weeze*
82.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Goldberg-Mildenitz*
83.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Bützow-Land*
84.	Niedersachsen	Göttingen	Gieboldehausen*
85.	Niedersachsen	Cloppenburg	Essen (Oldenburg)*
86.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Golzow*
87.	Hessen	Gießen	Hungen*
88.	Bayern	Cham	Furth im Wald*
89.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kranenburg*
90.	**Sachsen-Anhalt**	**Jerichower Land**	**Möckern***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 80, datë 27.1.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 89, datë 29.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
b) zogjve 24-orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Friuli-Venezia Giulia	Udine	Povoletto*
2.	Veneto	Verona	Oppeano*
3.	Veneto	Verona	Isola Della Scala*
4.	Piemonte	Alessandria	Occimiano*
5.	Emilia-Romagna	Bologna	Minerbio*
6.	Emilia-Romagna	Forli' - Cesena	Forli*
7.	Emilia-Romagna	Parma	Sorbolo*
8.	Lombardia	Lodi	Zelo Buon Persico*
9.	Lombardia	Cremona	Casale Cremasco-Vidolasco*
10.	Emilia-Romagna	Bologna	San Giovanni In Persiceto*
11.	Emilia-Romagna	Modena	Soliera*
12.	Emilia-Romagna	Ferrara	Voghiera*
13.	Emilia-Romagna	Modena	Modena*
14.	Lombardia	Brescia	Seniga*
15.	Piemonte	Novara	Novara*
16.	Lombardia	Mantua	Guidizzolo*
17.	Lombardia	Varese	Olgiate Olona*
18.	Lombardia	Mantua	Ceresara*
19.	Veneto	Venezia	Mira*
20.	Lombardia	Mantua	Goito*
21.	Lombardia	Mantua	Marmirolo*
22.	Lombardia	Mantua	Roverbella*
23.	Verona	Verona	Nogarole Rocca*
24.	Emilia-Romagna	Ferrara	Argenta*
25.	Piemonte	Torino	Front*
26.	Toscana	Pistoia	Agliana*
27.	Veneto	Treviso	Fonte*
28.	Emilia-Romagna	Ravenna	Lugo*
29.	Veneto	Verona	Vigasio*
30.	**Veneto**	**Verona**	**Verona***
31.	**Veneto**	**Verona**	**Valeggio Sul Mincio***
32.	**Emilia-Romagna**	**Parma**	**Noceto***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 41, datë 13.1.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 90, datë 29.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit

biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi nga i gjithë shteti i Maqedonisë së Veriut.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 91, datë 29.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produkteve të mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65°C në 39.8 sekonda;

ii. 70 °C në 3.6 sekonda;

iii. 74 °C në 0.5 sekonda;

iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2.	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3.	Śląskie	Gliwice	Toszek*
4.	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
5.	Podlaskie	Białystok	Łapy*
6.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
7.	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chełmża (rural)*
8.	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
9.	Podkarpackie	Przemyśl	Krasiczyn*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
11.	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
12.	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
13.	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
14.	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
15.	Mazowieckie	Wołomin	Tłuszcz*
16.	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
17.	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
18.	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
19.	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
20.	Pomorskie	Malbork	Miłoradz*
21.	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
22.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
23.	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
24.	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
25.	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
26.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*

27.	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
28.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
29.	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
30.	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
31.	Podlaskie	Mońki	Goniądz*
32.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
33.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
34.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
35.	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
36.	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
37.	Wielkopolskie	Leszno	Wijewo*
38.	Zachodniopomorskie	Białogard	Białogard (rural)*
39.	Podlaskie	Mońki	Knyszyn*
40.	Podlaskie	Sokółka	Janów*
41.	Opolskie	Opole	Niemodlin*
42.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jonkowo*
43.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
44.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
45.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Miedzichowo*
46.	Wielkopolskie	Rawicz	Miejska Górka*
47.	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
48.	Zachodniopomorskie	Gryfino	Gryfino*
49.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
50.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Opalenica*
51.	Małopolskie	Dąbrowa	Olesno*
52.	Podlaskie	Mońki	Krypno*
53.	Wielkopolskie	Szamotuły	Duszniki*
54.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
55.	Mazowieckie	Maków	Ploniawy-Bramura*
56.	Zachodniopomorskie	Koszalin	Sianów*
57.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
58.	Wielkopolskie	Kalisz	Lisków*
59.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Bytoń*
60.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Nowe Miasto Nad Wartą*
61.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*
62.	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*
63.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
64.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Osięciny*
65.	**Dolnośląskie**	**Milicz**	**Krośnice***
66.	**Wielkopolskie**	**Kalisz**	**Koźminek***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 74, datë 23.1.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Polonisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 92, datë 30.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Neuhardenberg*
2.	Bayern	Dingolfing-Landau	Simbach*
3.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Krempermarsch*
4.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Schenefeld*
5.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
6.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Ludwigslust-Land*
7.	Nordrhein-Westfalen	Paderborn	Delbrück*
8.	Nordrhein-Westfalen	Recklinghausen	Dorsten*
9.	Thüringen	Greiz	Zeulenroda-Triebes*
10.	Schleswig-Holstein	Plön	Lütjenburg*
11.	Niedersachsen	Cloppenburg	Garrel*
12.	Niedersachsen	Diepholz	Stuhr*
13.	Brandenburg	Potsdam-Mittelmark	Beetzsee*
14.	Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Röbel-Müritz*
15.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Torgelow-Ferdinandshof*
16.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen*
17.	Brandenburg	Oberhavel	Kremmen*
18.	Baden-Württemberg	Alb-Donau-Kreis	Langenau*
19.	Niedersachsen	Cloppenburg	Bösel*
20.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Geldern*
21.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Goch*
22.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Rees*
23.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kevelaer*
24.	Niedersachsen	Vechta	Vechta*
25.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Barnim-Oderbruch*
26.	Brandenburg	Prignitz	Plattenburg*
27.	Niedersachsen	Diepholz	Barnstorf*
28.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Föhr-Amrum*
29.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Sylt*
30.	Niedersachsen	Emsland	Geeste*
31.	Niedersachsen	Stade	Fredenbeck*
32.	Niedersachsen	Harburg	Tostedt*
33.	Niedersachsen	Oldenburg	Ganderkesee*
34.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Peenetal/Loitz*
35.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Letschin*
36.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Wriezen*
37.	Hessen	Wetteraukreis	Rockenberg*
38.	Niedersachsen	Cloppenburg	Friesoythe*
39.	Brandenburg	Uckermark	Lychen*
40.	Nordrhein-Westfalen	Wesel	Kamp-Lintfort*
41.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Selsingen*
42.	Niedersachsen	Vechta	Goldenstedt*
43.	Thüringen	Nordhausen	Ellrich*
44.	Sachsen-Anhalt	Mansfeld-Südharz	Goldene Aue*
45.	Niedersachsen	Emsland	Lengerich*
46.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Bremervörde*
47.	Niedersachsen	Stade	Oldendorf-Himmelpforten*
48.	Niedersachsen	Oldenburg	Harpstedt*
49.	Niedersachsen	Diepholz	Altes Amt Lemförde*
50.	Niedersachsen	Diepholz	Rehden*
51.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Miltzow*
52.	Sachsen	Meißen	Ebersbach*
53.	Bayern	Straubing-Bogen	Geiselhöring*
54.	Nordrhein-Westfalen	Rhein-Erft-Kreis	Hürth*
55.	Niedersachsen	Verden	Thedinghausen*
56.	Niedersachsen	Oldenburg	Großenkneten*
57.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Rietberg*
58.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Verl*
59.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Trave-Land*
60.	Niedersachsen	Grafschaft Bentheim	Wietmarschen*
61.	Nordrhein-Westfalen	Coesfeld	Lüdinghausen*
62.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kleve*
63.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Leezen*
64.	Niedersachsen	Oldenburg	Dötlingen*
65.	Sachsen-Anhalt	Anhalt-Bitterfeld	Zerbst/Anhalt*
66.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Versmold*
67.	Schleswig-Holstein	Ostholstein	Fehmarn*
68.	Niedersachsen	Aurich	Dornum*
69.	Nordrhein-Westfalen	Viersen	Kempen*
70.	Niedersachsen	Cloppenburg	Saterland*
71.	Niedersachsen	Osnabrück	Ostercappeln*
72.	Sachsen	Leipzig	Grimma*
73.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Recknitz-Trebeltal*
74.	Sachsen-Anhalt	Altmarkkreis Salzwedel	Gardelegen*
75.	Niedersachsen	Emsland	Haselünne*
76.	Brandenburg	Havelland	Ketzin/Havel*
77.	Baden-Württemberg	Schwarzwald-Baar-Kreis	Donaueschingen*
78.	Sachsen	Nordsachsen	Wermsdorf*
79.	Nordrhein-Westfalen	Hamm	Hamm*
80.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Sottrum*
81.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Weeze*
82.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Goldberg-Mildenitz*
83.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Bützow-Land*
84.	Niedersachsen	Göttingen	Gieboldehausen*
85.	Niedersachsen	Cloppenburg	Essen (Oldenburg)*
86.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Golzow*
87.	Hessen	Gießen	Hungen*

88.	Bayern	Cham	Furth im Wald*
89.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kranenburg*
90.	Sachsen-Anhalt	Jerichower Land	Möckern*
91.	**Sachsen**	**Leipzig**	**Geithain***
92.	**Niedersachsen**	**Osnabrück**	**Artland***
93.	**Sachsen-Anhalt**	**Harz**	**Osterwieck***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 88, datë 29.1.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 93, datë 30.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR, të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55ºC në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55ºC në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55ºC në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57ºC në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65ºC në 39.8 sekonda;

ii. 70ºC në 3.6 sekonda;

iii. 74ºC në 0.5 sekonda;

iv. 80ºC në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2.	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3.	Śląskie	Gliwice	Toszek*
4.	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*

5.	Podlaskie	Białystok	Łapy*
6.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
7.	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chełmża (rural)*
8.	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
9.	Podkarpackie	Przemyśl	Krasiczyn*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
11.	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
12.	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
13.	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
14.	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
15.	Mazowieckie	Wołomin	Tłuszcz*
16.	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
17.	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
18.	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
19.	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
20.	Pomorskie	Malbork	Miłoradz*
21.	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
22.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
23.	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
24.	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
25.	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
26.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
27.	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
28.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
29.	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
30.	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
31.	Podlaskie	Mońki	Goniądz*
32.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
33.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
34.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
35.	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
36.	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
37.	Wielkopolskie	Leszno	Wijewo*
38.	Zachodniopomorskie	Białogard	Białogard (rural)*
39.	Podlaskie	Mońki	Knyszyn*
40.	Podlaskie	Sokółka	Janów*
41.	Opolskie	Opole	Niemodlin*
42.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jonkowo*
43.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
44.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
45.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Miedzichowo*
46.	Wielkopolskie	Rawicz	Miejska Górka*
47.	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
48.	Zachodniopomorskie	Gryfino	Gryfino*
49.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
50.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Opalenica*
51.	Małopolskie	Dąbrowa	Olesno*
52.	Podlaskie	Mońki	Krypno*
53.	Wielkopolskie	Szamotuły	Duszniki*
54.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
55.	Mazowieckie	Maków	Płoniawy-Bramura*
56.	Zachodniopomorskie	Koszalin	Sianów*
57.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
58.	Wielkopolskie	Kalisz	Lisków*
59.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Bytoń*
60.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Nowe Miasto Nad Wartą*
61.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*
62.	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*
63.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
64.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Osięciny*
65.	Dolnośląskie	Milicz	Krośnice*
66.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
67.	**Warmińsko-Mazurskie**	**Iława**	**Lubawa (rural)***
68	**Łódzkie**	**Skierniewice**	**Lipce Reymontowskie***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 91, datë 29.1.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Polonisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 94, datë 30.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
b) zogjve 24-orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
1.	Csongrád-Csanád	Szentes*
2.	Nógrád	Balassagyarmat*
3.	Békés	Orosháza*
4.	Békés	Szarvas*
5.	**Jász-Nagykun-Szolnok**	**Kunszentmárton***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 87, datë 28.1.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

VENDIM
Nr. 27, datë 29.1.2026

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR KOORDINIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NDËRINSTITUCIONAL NDËRMJET KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NË FUSHËN E FORMIMIT PROFESIONAL TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE DHE TË PROKURORISË"

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 147 dhe 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 61, pika 2, germa "ë" dhe nenit 170, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, me propozim të mbledhjes së përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në fushën e formimit profesional të administratës gjyqësore dhe të prokurorisë", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Ilir Rusi

RREGULLORE
PËR KOORDINIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NDËRINSTITUCIONAL NDËRMJET KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NË FUSHËN E FORMIMIT PROFESIONAL TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE DHE TË PROKURORISË

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton parimet dhe procedurat e bashkëpunimit institucional ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë për koordinimin e politikave, objektivave strategjikë, nevojave për trajnim, dhe aktiviteteve në fushën e formimit profesional të administratës gjyqësore, dhe të prokurorisë me synim orientimin drejt shërbimeve eficiente dhe të aksesueshme për çdo person.

2. Qëllimi kryesor është krijimi i një qasjeje të unifikuar dhe efektive për formimin dhe zhvillimin profesional të administratës gjyqësore dhe asaj të prokurorisë, duke rritur cilësinë, shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës, orientimin e politikave dhe kuadrit strategjik, dhe shfrytëzimin e maksimizimin e burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukturës.

3. Kjo rregullore përforcon koordinimin ndërinstitucional dhe bashkërendimin në fushën me interes të përbashkët të formimit profesional, duke u mbështetur në rregulloren e përbashkët "Për mbledhjet e përbashkëta dhe bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë".

Neni 2
Parimet e bashkëpunimit

Koordinimi ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë bazohet në parimet e pavarësisë kushtetuese, transparencës, efikasitetit, vendosjes së standardeve të unifikuara për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale, barazisë së mundësive, uljes së kostove dhe shmangien e barrës financiare shtesë, si dhe bashkërendimit me institucione të tjera, si: Shkolla e

Magjistraturës, Ministria e Drejtësisë dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Neni 3
Fushat e bashkëpunimit dhe koordinimit

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë bashkëpunojnë për formimin profesional të administratës gjyqësore dhe të prokurorisë, në fushat e mëposhtme:

a) Vlerësimi i nevojave për programin e formimit fillestar dhe vazhdues, nëpërmjet analizave dhe konsultimeve të përbashkëta;

b) Identifikimi i objektivave strategjikë të përbashkët dhe koordinimi i politikave kryesore ndërvepruese, me qëllim garantimin e një shërbimi cilësor;

c) Hartimi i programeve të formimit fillestar e vazhdues, si dhe moduleve të trajnimit me tematika të përbashkëta për administratën gjyqësore dhe të prokurorisë;

d) Zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta mbi tematika të njëjta, si: menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi financier, rregullat e etikës dhe shmangies së konfliktit të interesit, mbrojtjes së të dhënave personale, komunikimit me publikun apo fusha të tjera me interes të përbashkët;

e) Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të trajnimeve përmes metodave të harmonizuara;

f) Shkëmbimi i praktikave të mira dhe i raporteve vjetore të progresit;

g) Bashkërendimi me Shkollën e Magjistraturës, me qëllim përfitimin e ekspertizës më të mirë dhe identifikimin e objektivave strategjikë të përbashkët për një sistem drejtësie efikas, transparent e gjithëpërfshirës;

h) Bashkërendimi me Shkollën e Administratës Publike, me qëllim shkëmbimin e ekspertizës dhe identifikimin e objektivave strategjikë të përbashkët;

i) Bashkërendimi me institucione të tjera vendore apo ndërkombëtare, organizatat e projekteve partnere, me fokus formimin profesional të administratës gjyqësore, të sistemit të prokurorisë apo administratës publike në përgjithësi;

j) Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës së nevojshme për trajnim, burimeve për trajnim, përfshirë infrastrukturën fizike, platformat digjitale, ekspertët dhe materialet mësimore.

Neni 4
Struktura koordinuese e përbashkët

1. Procedurat dhe format e bashkëpunimit ndërmjet këshillave, të parashikuara në rregulloren e përbashkët, "Për mbledhjet e përbashkëta dhe bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë", zbatohen për aq sa është e mundur edhe në fushën e formimit profesional të administratës gjyqësore dhe të prokurorisë.

2. Komisionet e planifikimit strategjik, administrimit dhe buxhetit shqyrtojnë zhvillimet në fushën e formimit profesional të administratës gjyqësore dhe të prokurorisë në mbledhjet e përbashkëta që zhvillojnë të paktën një herë në gjashtë muaj përgjatë një viti.

3. Departamentet dhe strukturat përkatëse, përgjegjëse për formimin profesional të administratës gjyqësore dhe të prokurorisë, shqyrtojnë zhvillimet për të bashkërenduar punën sipas parimeve dhe fushave të bashkëpunimit në këtë rregullore, koordinojnë përdorimin e përbashkët të infrastrukturës së nevojshme për trajnim, burimeve për trajnim, përfshirë infrastrukturën fizike, platformat digjitale, ekspertët dhe materialet mësimore, dhe ndjekin zbatimin e vendimeve në mbledhjet e tyre të përbashkëta që zhvillohen të paktën një herë në tre muaj.

4. Strukturat përkatëse, përgjegjëse për formimin profesional të administratës gjyqësore dhe të prokurorisë, shërbejnë si pika kontakti për komunikim dhe bashkërendim midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ato ndihmojnë në koordinimin dhe bashkëpunimin, përgatitjen, rishikimin dhe shpërndarjen e dokumentacionit përkatës dhe konkluzioneve të mbledhjeve të përbashkëta.

5. Strukturat përkatëse, përgjegjëse për formimin profesional të administratës gjyqësore dhe të prokurorisë, monitorojnë dhe mbështesin zbatimin e vendimeve të përbashkëta dhe përgatisin një raport tremujor të zbatimit të fushave të bashkëpunimit sipas kësaj rregulloreje, i cili i përcillet mbledhjeve të përbashkëta të departamenteve apo komisioneve përkatëse.

6. Mbledhja e përbashkët e departamenteve harton dhe propozon për miratimin nga komisionet e planifikimit strategjik, administrimit dhe buxhetit, planet vjetore të formimit profesional.

7. Komisionet e planifikimit strategjik, administrimit dhe buxhetit përfshijnë temat e trajnimit profesional të përbashkët në programet e trajnimit fillestar dhe vazhdues për t'u miratuar nga këshillat sipas rregulloreve përkatëse.

8. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë përfshijnë në raportet e tyre vjetore edhe të dhëna për formimin profesional të administratës gjyqësore dhe të prokurorisë, fushat e bashkëpunimit dhe koordinimit mes tyre, tematikat e përbashkëta të trajtuara, treguesit e pjesëmarrjes dhe vlerësimet e pjesëmarrësve, si dhe identifikimin e problematikave apo boshllëqeve në zbatim dhe rekomandime për përmirësim.

Neni 5
Marrëdhënia me institucione të tjera dhe partnerë ndërkombëtarë

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë bashkëpunojnë me qëllim koordinimin me:

a) Shkollën e Magjistraturës, për zhvillimin e politikave e të programeve të përbashkëta; përfitimin e ekspertizës më të mirë dhe identifikimin e objektivave strategjikë të përbashkët për një sistem drejtësie efikas;

b) Shkollën e Administratës Publike, me qëllim shkëmbimin e ekspertizës dhe identifikimin e objektivave strategjikë të përbashkët;

c) Ministrinë e Drejtësisë, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe institucionet e tjera publike, për shkëmbim informacioni dhe harmonizim politikash;

d) Partnerët ndërkombëtarë dhe organizata partnere, për mbështetje teknike dhe financiare në ndërtimin e kapaciteteve të hartimit dhe zhvillimit të programeve të formimit profesional.

2. Në hartimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione apo organizata partnere në fushën e formimit profesional të administratës gjyqësore dhe të prokurorisë, këshillat synojnë të përfshijnë, ndër të tjera, parimet dhe fushat e bashkëpunimit të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 6
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore miratohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Ndryshimet dhe shtesat e kësaj rregulloreje bëhen vetëm me dakordësi të përbashkët dhe miratohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

VENDIM
Nr. 4, datë 15.1.2026

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN DHJETOR 2025, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018, dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 75 prot., datë 9.1.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV",

konstatoi se:

I. Aspektet ligjore dhe procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga FSHU sh.a.

Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 6832 prot., datë 31.12.2025, protokolluar në ERE me nr. 3178 prot., datë 31.12.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin dhjetor 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe "Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar.

II. Analiza e përllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin dhjetor 2025, FSHU sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokuruara, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

2. Përllogaritja e Çmimit Mesatar të Ponderuar të Blerjes (ÇBEt)

Bazuar në të dhënat e paraqitura, FSHU sh.a. ka përllogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin dhjetor 2025 në vlerën 12.15 lekë/kwh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 12.15 lekë/kwh, në përputhje me përllogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

3. Komponentët sipas metodologjisë (neni 8, vendimi nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë, si më poshtë:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) për muajin dhjetor 2025: 12.15 lekë/kwh;
- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 279, datë 16.12.2024: 0.85 lekë/kwh;
- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, "Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022": 1.55 lekë/kwh;
- Kostot administrative: 1.06 lekë/kwh;
- Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive në harkun kohor 27.11.2025–30.12.2025.
- Në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2025, përllogaritet, si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin dhjetor 2025			
		Njësia	**Çmimi**
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	12.15
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA		**Lekë/kWh**	**15.98**

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:
- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit rezulton *15.98* lekë/kwh për muajin dhjetor 2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2025 prej 15.98

lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategorinë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 5, datë 15.1.2026

MBI PEZULLIMIN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "SUNPRO" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; nenit 14, pika 10, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s"; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135 prot., datë 13.1.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'SunPro' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 98, datë 12.5.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "SunPro" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje ne Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë.

- Në vijim, pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 148, datë 8.7.2025, pezulloi afatin e vendimmarrjes së Bordit për licencimin e shoqërisë "SunPro" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i lënë kohë asaj për depozitimin e dokumentacionit të munguar deri në datën 30.9.2025.

- Pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 212, datë 9.9.2025, vendosi që pika 2 e vendimit nr. 148/2025, të ndryshohet dhe të bëhet: "Brenda datës 22.11.2025, shoqëria duhet të depozitojë në ERE përgjigjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. për aplikimin e bërë për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit".

- Në vijim të sa depozituar nga shoqëria, me vendimin nr. 319, datë 12.12.2025, Bordi i ERE-s vendosi të heqë pezullimin e procedurës dhe të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë, me qëllim zhvillimin e korrespondencës përkatëse me OST sh.a., në lidhje me pikën e lidhjes së centralit eolik me rrjetin e transmetimit dhe me vetë shoqërinë në lidhje me afatet e vënies në punë të centralit.

- Me shkresat nr. 1648/23 prot., dhe nr. 1648/24 prot., datë 18.12.2025, ERE ka njoftuar përkatësisht shoqërinë "SunPro" sh.p.k. dhe OST sh.a., për zhvillimin e një seance dëgjimore.

- Seanca është zhvilluar në ERE në datën 23.12.2025, ku përfaqësuesi i OST sh.a. bëri me dije se pasi është pajisur me miratim paraprak, shoqëria ka paraqitur kërkesë për ndryshimin e pikës së lidhjes, procedurë e cila po ndiqet nëpërmjet një grupi pune dhe u mor angazhimi për të depozituar në ERE një përgjigje, në lidhje me aplikimin e shoqërisë brenda muajit dhjetor 2025. Ky angazhim iu kujtua OST sh.a. me *e-mail*-in e ERE-s nr.

1648/28 prot., datë 24.12.2025. Nga OST sh.a. nuk rezulton të jetë depozituar ende ndonjë përgjigje, por sikurse është sqaruar dhe në seancën përkatëse dëgjimore, aksesi në rrjet është i garantuar për subjektet që pajisen me autorizimin/miratimin përkatës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e një burimi të ri gjenerues të energjisë elektrike.

- Nga përfaqësuesit e shoqërisë u bë me dije se do të përditësohet në vijim informacioni në lidhje me vitin e ndërtimit dhe datën e fillimit të operimit dhe do të depozitohen në ERE raportimet përkatëse të depozituara në MIE, në kuadër të ecurisë së zhvillimit të projektit eolik. Nëpërmjet *e-mail*-it nr. 1648/27 prot., datë 24.12.2025, ERE i ka dërguar shoqërisë një përmbledhje të sa diskutuar në seancë, ku i është sjellë në vëmendje dhe detyrimi për të dërguar në ERE informacionin/dokumentacionin shtesë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1648/29 prot., datë 29.12.2025, shoqëria ka bërë me dije se i është drejtuar MIE-s, ku pasi e ka informuar për ecurinë e projektit dhe pengesat e hasura, ka kërkuar rishikimin e afatit për pajisje me leje ndërtimi, ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik, me 18 muaj, ndaj përditësimi i parashikimeve të datës së ndërtimit dhe vënies në punë të centralit, mbetet i kushtëzuar nga përgjigjja dhe konfirmimi i autoritetit kontraktor. Kjo shkresë është depozituar dhe në ERE.

Pezullimi i afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 66, pika 1 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", kur shqyrtimi i një çështjeje administrative varet nga një çështje tjetër ligjore e pavarur ("çështje paraprake"), për të cilën është kompetente një gjykatë ose organ tjetër, organi administrativ ka të drejtë të pezullojë procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë dhe njofton palët për pezullimin.

- Gjithashtu, në nenin 14, pika 10, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë, rast pas rasti, pezullimin e vendimmarrjes pas fillimit të procedurës.

- Për gjithë sa më sipër, për sa informuar e depozituar nga shoqëria, referuar dhe parashikimeve të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, vlerësohet pezullimi i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "SunPro" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë deri në depozitimin në ERE të përgjigjes/qëndrimit të MIE-s për kërkesën e bërë nga shoqëria, në lidhje me shtyrjen e afateve për pajisjen me lejet e nevojshme, ndërtimin dhe vënien në punë të parkut eolik.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "SunPro" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, deri në depozitimin në ERE nga shoqëria të përgjigjes/qëndrimit zyrtar të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, lidhur me kërkesën e saj për shtyrjen e afateve për pajisjen me lejet e nevojshme, ndërtimin dhe vënien në punë të parkut eolik.

2. Ky vendim do t'i nënshtrohet rishikimit nga ERE pas depozitimit nga ana e shoqërisë "SunPro" sh.p.k. të dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "SunPro" sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 6, datë 15.1.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "NOVA SOLAR SYSTEM" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e", dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 7/1 prot., datë 13.1.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Nova Solar System' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Nova Solar System" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 7 prot., datë 6.1.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", dhe "d"; për pikën 1.3 germën "c"; si dhe pikën 2.5.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se nevojitet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- Germa "b": Duhet të depozitohet dëshmia e penalitetit për vetë shoqërinë.

- Germa "c": Në dokumentin e strukturës organizative duhet të saktësohen ortakët dhe të plotësohet vendimi i organeve drejtuese për miratimin e strukturës. Po ashtu, shoqëria duhet të depozitojë informacion mbi stafin aktual efektiv.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- Germa "a": Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin që nuk ka detyrime tatimore të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- Germa "b": Shoqëria duhet të depozitojë vendimin e organeve drejtuese të saj, ku të dedikohet shuma përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Nova Solar system" sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 7, datë 15.1.2026

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "DEVOLL HYDROPOWER" SHA PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 134 prot., datë 13.1.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Devoll Hydropower' sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., e licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 81, datë 9.6.2016, dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 134, datë 7.6.2021, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2825/1 prot., datë 10.12.2025, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, brenda afatit të aplikimit për rinovim.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 335, datë 18.12.2025, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.12.2025 dhe 22.12.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve, apo të objeksioneve nga të tretët (data 29.12.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 2825/4 prot., datë 24.12.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/ dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 20 prot., datë 6.1.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin shtesë, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se shoqëria duhet të plotësojë dhe sa vijon:

- Informacion të përditësuar në lidhje me statusin e shqyrtimit gjyqësor, në lidhje me detyrimet tatimore.

- Informacion të përditësuar në lidhje me stafin aktual efektiv që angazhohet me veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Planin e biznesit të përditësuar me kostot, shpenzimet dhe të ardhurat përkatëse.

- Vendimin e organeve drejtuese të shoqërisë ku të dedikohet shuma përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë.

- Informacion mbi nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët.

Zgjatja e vendimmarrjes së Bordit

- Në nenin 14, pika 3, parashikohet, se: "Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë".

- Për sa më lart, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 81, datë 9.6.2016, dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 134, datë 7.6.2021.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja dijeni, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Devoll Hydropower" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 8, datë 15.1.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË "INFO-TELECOM" SHPK PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e", 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 133 prot., datë 13.1.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'INFO-telecom' sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "INFO-telecom" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.6.2021, me afat licence deri më 24.6.2026.

- Në nenin 16, pika 1, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 491, seria T21, është 24.6.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 24.12.2025.

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e saj nr. 99 prot., datë 23.12.2025, e cila është protokolluar në ERE, me nr. 2984/1 prot., datë 29.12.2025. Gjithashtu, rezulton se pagesa për rinovimin e licencës është kryer në datën 18.12.2025, pra konstatohet se shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të rregullores, vlerësohet se shoqëria duhet të sqarojë/plotësojë dhe sa vijon:

- deklaratën e kërkuar në germën "c", të shtojcës 1, të rregullores dhe autorizimin për përfaqësuesin ligjor;

- strukturën organizative aktuale;

- parashikimin e sasisë së energjisë që do të tregtojë 5 vjetët e ardhshëm të ushtrimit të aktivitetit, plotësimin e planit të biznesit e, po ashtu, dedikimin e mbështetjes financiare përkatëse.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 491, seria T21, të shoqërisë "INFO-telecom" sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.6.2021.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "INFO-telecom" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të

ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 9, datë 15.1.2026

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË "GREEN PLUS ENERGY" SHPK, SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ "PROCREDIT BANK" SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/ aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 121 prot., datë 13.1.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Green Plus Energy' sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve",

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë "Green Plus Energy" sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria me shkresën nr. 2974 prot., datë 5.12.2025, ka paraqitur aplikim dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse "ProCredit Bank" sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria "Green Plus Energy" sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 14.2.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- ERE me shkresën nr. 2974/1 prot., datë 18.12.2025 dhe *e-mail*-it të nisur më datë 5.1.2026, protokolluar në vijim në ERE me nr. 6 prot., datë 5.1.2026, i ka bërë me dije informacionin/ dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në këtë aplikim.

3. Dorëzimi i dokumentacionit plotësues

- Shoqëria në përgjigje, nëpërmjet *e-mail*-it datë 7.1.2026 dhe me shkresën nr. 6/1 prot., datë 7.1.2026, ka përcjellë informacionin e kërkuar.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria "Green Plus Energy" sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:

- Neni 5, pika 2: Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 4: Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.

- Neni 5, pika 5: Shoqëria kërkon që të mbahet konfidencial informacioni lidhur me kontratat e kredisë, deklaratat dhe formulari i lejes së ndërtimit, duke qenë se përbëjnë të dhëna financiare dhe personale që mbrohet nga legjislacioni në fuqi. Për sa kërkuar nga shoqëria vlerësohet se kërkesa për konfidencialitet pranohet për pjesët e dokumentacionit që përmbajnë të dhëna financiare sensitive; në publikime/njoftime, këto të dhëna do të anonimizohen/redaktohen, duke ruajtur transparencën mbi elementet thelbësore të vendimmarrjes.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- Pika 1: Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës siguruese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave.

- Pika 2: Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- Germa "a": Ekstrakti historik i regjistrit tregtar.

- Germa "b": Vendimi i organeve drejtuese: ka depozituar vendimin e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë "Green Plus Energy" sh.p.k., të datës 30.9.2025, me anë të së cilës është shprehur dakortësia mbi vendosjen e kuotave të kësaj shoqërie si garanci për shlyerjen e detyrimit ndaj ProCredit Bank sh.a.

- Germa "c": Marrëveshjet përkatëse:

- "Kontratën e kredisë bankare" nr. 2287 rep, nr. 1396 kol., datë 30.9.2025, nënshkruar midis palëve, e cila do të përdoret nga kredimarrësi për kapital qarkullues për ndërtimin e Parkut Fotovoltaik.

- "Kontratën e kredisë bankare" nr. 2288 rep, nr. 1397 kol., datë 30.9.2025, për qëllime të përmbushjes së Projektit të Parkut Fotovoltaik

- Pika 3: Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë "Green Plus Energy" sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja është nënshkruar me bankë vendëse, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Në referencë të nenit 9, pika 8, të rregullores, ku citohet se shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar, ku të reflektohet ndryshimi vendosja e kolateralit mbi kuotat e saj, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së nga ku të reflektohet ky ndryshim/transferim.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguruese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë "Green Plus Energy" sh.p.k si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse "Procredit Bank" sh.a. (sipas kontratave të kredisë me nr. 2287 rep., nr. 1396 kol., datë 30.9.2025 dhe nr. 2288 rep., nr. 1397 kol., datë 30.9.2025).

2. Dhënia e autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë "Green Plus Energy" sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria "Green Plus Energy" sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikës 2 dhe 3, si dhe në rast se nga MIE depozitohet një qëndrim ndryshe në lidhje me detyrimet që i burojnë shoqërisë nga kontrata e nënshkruar datë 28.4.2023, apo në rast të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje.

5. Drejtoria e Licencimit dhe e Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Green Plus Energy" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 10, datë 15.1.2026

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "AGE ERZEN" SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa "a", dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15, të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 12/3 prot., datë 13.1.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Age Erzen' sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve",

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës për autorizim

- Shoqëria "Age Erzen" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 154, datë 31.7.2024, nga HEC "Hekali" me kapacitet prodhues 1.94 mw, në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.

- Me shkresën nr. 2430/2 prot., datë 22.9.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për miratimin e ERE-s, në lidhje me transferimin e aseteve, për të garantuar detyrimin ndaj Banka OTP Albania sh.a.

2. Fillimi i procedurës për transferimin e aseteve

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 251, datë 8.10.2025, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë.

- ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nëpërmjet shkresës nr. 2430/14 prot., datë 31.10.2025, në lidhje me këtë vendim.

3. Procedura vijuese dhe vlerësimi i dokumentacionit

- Me shkresën nr. 2430/6 prot., datë 16.10.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe i ka bërë me dije dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2430/9 prot., datë 24.10.2025, depozitoi dokumentacion/informacion shtesë, nga analizimi i të cilit u konstatua mungesa e listës së detajuar të aseteve fikse me vlerat përkatëse dhe totale të tyre.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 325, datë 15.12.2025, vendosi të zgjasë deri në 30 ditë afatin e vendimmarrjes në lidhje me aplikimin për transferimin e aseteve fikse të shoqërisë, në mënyrë që të saktësohej si me shoqërinë edhe me bankën disponimi i listës së aseteve.

- ERE, me shkresën nr. 2430/22 prot., datë 18.12.2025 njoftoi shoqërinë dhe bankën mbi zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 22.12.2025, për të sqaruar sa munguar në këtë aplikim. Seancë, e cila nuk u zhvillua, pasi shoqëria nëpërmjet *email*-in të datës 22.12.2025 dhe banka me *email*-in e datës 30.12.2025, sqaruan se kishin marrë njoftimin/shkresën me vonesë, ndaj kërkuan që të planifikohet në vijim një datë tjetër seance.

- Me *email*-in e datës 5.1.2026 dhe shkresën nr. 12/1 prot., datë 6.1.2026, ERE njoftoi si shoqërinë, ashtu edhe bankën, për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 9.1.2026, ku u bënë sqarimet përkatëse dhe nga ana e shoqërisë dhe e bankës, u mor angazhimi për të depozituar në ERE

dokumentacionin e munguar (listën e detajuar të aseteve si pjesë integrale e kontratës/marrëveshjes siguruese).

- Me *e-mail*-in e datës 12.1.2026 dhe shkresën nr. 12/2 prot., datë 12.1.2026, shoqëria "Age Erzen" sh.p.k. ka përcjellë në ERE vetëm listën e aseteve të projektit HEC Hekal, pra jo në formën e duhur/të kërkuar.

- ERE me *e-mail*-in e datës 13.1.2026, i ka risjellë në vëmendje shoqërisë sa sqaruar dhe lënë detyrë në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 9.1.2026, se lista duhet të jetë pjesë integrale e kontratës/ marrëveshjes siguruese të aseteve të nënshkruar me bankën (si aneks i saj) dhe të depozitohet në ERE në formën ligjore të kërkuar.

4. Zgjatja e vendimmarrjes së Bordit

- Për të gjitha sa më sipër vlerësohet që të përcillet në ERE lista e aseteve si pjesë integrale e kontratës/marrëveshjes siguruese, ndaj vlerësohet të zgjatet me 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE mbi kërkesën e shoqërisë "Age Erzen" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "Banka OTP Albania" sh.a.

- Referuar nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Bordi i ERE-s vlerësohet zgjatja me 30 ditë të vendimmarrjes përfundimtare në lidhje me kërkesën e shoqërisë "Age Erzen" sh.p.k. për transferimin e aseteve fikse të saj nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese, në mënyrë që të përcillet lista e aseteve si pjesë integrale e kontratës/marrëveshjes siguruese nënshkruar me Bankën OTP Albania sh.a. Shoqëria duhet ta depozitojë këtë dokumentacion brenda 20 ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "Age Erzen sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "Banka OTP Albania" sh.a.

2. Brenda 20 ditëve nga marrja dijeni, shoqëria duhet të plotësojë dokumentacionin e munguar për këtë aplikim.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Age Erzen" sh.p.k. dhe Bankën OTP Albania sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 11, datë 15.1.2026

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 262, DATË 21.10.2025, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'VIVID POWER' SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve me nr. 41/11 prot., datë 9.1.2026, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 262, datë 21.10.2025, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Vivid Power' sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike'",

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "Vivid Power" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 262, datë 21.10.2025, ka licencuar shoqërinë "Vivid Power" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

- Në pikën 2 të vendimit nr. 262/2025 është përcaktuar, se: "Me fillimin e operimit, shoqëria të depozitojë në ERE informacionin e përditësuar, në lidhje me sistemin IT dhe strukturën organizative me stafin teknik efektiv për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike".

- Në pikën 3 të vendimit nr. 262/2025 është përcaktuar se brenda datës 4.1.2026, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të

huapërdorjes për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës".

- Në pikën 4 të vendimit nr. 262/2025 është përcaktuar se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- ERE, në kuadër të ndjekjes së kushteve të vendimit nr. 262/2025, me shkresën nr. 2923 prot., datë 21.11.2025, i ka kërkuar shoqërisë "Vivid Power" sh.p.k. informacion në lidhje me sistemin IT dhe strukturën organizative, si dhe depozitimin e dokumentacionit për disponimin e zyrave, me afat vlefshmërie të njëjtë me afatin e licencës, deri më 21.10.2030.

- Shoqëria "Vivid Power" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 41 prot., datë 7.1.2026, ka depozituar informacion në kuadër të pikës 2 të vendimit nr. 262/2025, duke sqaruar se nuk ka filluar ende operimin në veprimtarinë e furnizimit dhe se për sa i përket sistemit IT dhe stafit, në vitet e para të operimit do të ketë suport nga shoqëria "GENER 2" sh.p.k.

- Në kuadër të plotësimit të pikës 3 të vendimit nr. 262/2025, shoqëria ka depozituar "Shtojcë nr. 1 e marrëveshjes së huapërdorjes, datë 4.1.2023", të noterizuar me nr. rep. 6582, datë 29.12.2025, e nënshkruar midis shoqërisë "GENER 2" sh.p.k. (huadhënës) dhe shoqërisë "Vivid Power" sh.p.k. (huapërdorues), me objekt dhënien në përdorim të një posti pune në katin e 7-të të ndërtesës "ABA Business Center", me adresë në rrugën "Papa Gjon Pali II", Tiranë, për periudhën 5.1.2026–4.1.2031.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Duke qenë se shoqëria nuk ka filluar ende operimin në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, si dhe në zbatim të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", përkatësisht pikës 2.4, germa "b", vlerësohet se kushti i lënë në pikën 2 të vendimit nr. 262/2025 duhet të mbetet i pandryshuar, deri në depozitimin e marrëveshjes për vënien në përdorim të shërbimit IT dhe paraqitjen e strukturës organizative me stafin teknik efektiv.

- Referuar dokumentacionit të depozituar për disponimin e zyrave, si dhe kërkesës së rregullores (pika 2.4, germa "c"), vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtin e lënë në pikën 3 të vendimit nr. 262/2025, pasi afati i vlefshmërisë së kontratës (deri më 4.1.2031) mbulon periudhën e licencës (deri më 21.10.2030).

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet, apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pika 3 e vendimit nr. 262/2025 duhet të shfuqizohet, ndërsa pika 4 e këtij vendimi vlerësohet të ndryshojë për të reflektuar faktin se rishikimi i vendimit lidhet vetëm me plotësimin ose mosplotësimin e kushtit të përcaktuar në pikën 2 të tij.

- Me rishikimin e pikës 3 të këtij vendimi, lind nevoja për ndryshimin edhe të pikës 4 të tij, duke specifikuar rrethanat se kur mund të jetë objekt rishikimi ky vendim. Për rrjedhojë, vlerësohet ndryshimi i pikës 4 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 262, datë 21.10.2025, si me përmbajtje si vijon: "Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2.".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 262, datë 21.10.2025, si vijon:

a) Pika 3 shfuqizohet:

b) Pika 4 ndryshon dhe bëhet:

"Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2.".

2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve të njoftojë shoqërinë "Vivid Power" sh.p.k., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të

konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 12, datë 15.1.2026

MBI DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 234, DATË 5.11.2024, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'DELTA PLAN STUDIO' SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 25/1 prot., datë 14.1.2026, "Mbi disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 234, datë 5.11.2024, "Mbi licencimin e shoqërisë shoqërinë 'Delta Plan Studio' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "Delta Plan Studio" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 234, datë 5.11.2024, ka licencuar shoqërinë "Delta Plan Studio" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, për një afat 30-vjeçar.

- Në kuptim të pikave 2 dhe 3 të vendimit nr. 234/2024, shoqëria duhet të dokumentojë fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaik brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake (brenda datës 18.12.2025), ose duhet të depozitojë në ERE një VNM Paraprake të re, si dhe duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE.

- Në pikën 4 të vendimit nr. 234/2024, përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- ERE me shkresën nr. 2536 prot., datë 29.9.2025, ka kërkuar informacion ndaj shoqërisë lidhur me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaik brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake. Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria "Delta Plan Studio" sh.p.k. me shkresën nr. 12/1 prot., datë 3.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2533/1 prot., datë 6.10.2025 ka bërë me dije se nuk ka filluar ende punimet për ndërtimin e centralit fotovoltaik, pasi janë në pritje të pajisjes me leje zhvillimi dhe në rast se nuk do të fillojnë punimet brenda afatit të përcaktuar do të depozitojnë një VNM paraprake të re.

- Në vijim, shoqëria "Delta Plan Studio" sh.p.k. me shkresën nr. 1 prot., datë 6.1.2026, protokolluar në ERE me nr. 25 prot., datë 7.1.2026 ka depozituar VNM paraprake të re, për shkak se nuk ka arritur të fillojë punimet brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE nr. 234, datë 5.11.2024.

- VNM paraprake e re është lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit më datë 6.1.2026, me nr. serie AN091220250068 dhe nr. komisioni 02 dhe në të gjithashtu përcaktohet, se: "Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para" .

- Gjithashtu, në referencë të kushtit të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE nr. 234, datë 5.11.2024, shoqëria bën me dije se është ende në pritje të pajisjes me leje zhvillimi dhe më tej me leje ndërtimi nga ana e organeve përkatëse.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në kushtet e depozitimit të VNM paraprake të re nga ana e shoqërisë, vlerësohet se është e nevojshme të rishikohet afati i përcaktuar në pikën 2 të vendimit të ERE-s nr. 234, datë 5.11.2024.

- Vlerësohet se pika 2 e vendimit nr. 234/2024, duhet të ndryshohet si vijon: "Shoqëria duhet të dokumentojë fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaik brenda datës 6.1.2028, ose duhet të depozitojë në ERE një VNM Paraprake të re".

- Gjithashtu, në referencë të kushtit të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të ERE-s nr. 234, datë 5.11.2024, ku shoqëria bën me dije se është ende në pritje të pajisjes me leje zhvillimi dhe më tej me leje ndërtimi nga ana e organeve përkatëse, lind nevoja që pas pikës 3 të shtohet pika 3/1 me përmbajtje si vijon: "Jo më vonë se 60 ditë nga fillimi i ushtrimit të aktivitetit shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës".

- Në vijim vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 4 të vendimit nr. 234/2024, i cili përcakton se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, me qëllim saktësimin e objektit duke e riformuluar si vijon: "Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në rast të plotësimit/ mosplotësimit të kushteve të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi".

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësojmë që duhet të ndryshohen pikat 2 dhe 4 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 234, datë 5.11.2024, si dhe pas pikës 3 të tij, të shtohet pika 3/1 si më sipër argumentuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe të ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 234, datë 5.11.2024, si vijon:

a) Pika 2 e vendimit të ERE-s nr. 234, datë 5.11.2024, ndryshon dhe bëhet: "Shoqëria duhet të dokumentojë fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaik brenda datës 6.1.2028, ose duhet të depozitojë në ERE një VNM paraprake të re".

b) Pas pikës 3 të vendimit të ERE-s nr. 234, datë 5.11.2024, shtohet pika 3/1 me përmbajtje si vijon: "Jo më vonë se 60 ditë nga fillimi i ushtrimit të aktivitetit duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës".

c) Pika 4 e vendimit të ERE-s nr. 234, datë 5.11.2024, ndryshon dhe bëhet: "Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi".

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë "Delta Plan Studio" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, "OSSH" sh.a., "FTL" sh.a. dhe "ALPEX" sh.a., lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 13, datë 15.1.2026

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 262, DATË 2.12.2024, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'SLR ALBANIA' SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e

Politikave të Burimeve të Rinovueshme me nr. 36/1 prot., datë 14.1.2026, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 262, datë 2.12.2024, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'SLR Albania' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike' i ndryshuar",

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "SLR Albania" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 262, datë 2.12.2024, ka licencuar shoqërinë "SLR Albania" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 mw.

- Në kuptim të pikës 2, të vendimit të nr. 262/2024, përcaktohet se: Përpara fillimit të operimit, shoqëria "SLR Albania" sh.p.k. të depozitojë në ERE, VNM-në paraprake të re. Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 294, datë 26.12.2024, pika 2 e vendimit të lartpërmendur është shfuqizuar.

- Referuar pikës të 3, të vendimit nr. 262/2024, shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të përcaktuara nga kontrata me MIE-n.

- Gjithashtu, në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se: "Ky vendim është objekt rishikimi në zbatim të plotësimit të pikave 2 dhe 3".

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- ERE, me shkresën nr. 2536 prot., datë 29.9.2025, ka kërkuar informacion ndaj shoqërisë, lidhur me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të përcaktuara nga kontrata me MIE-n.

- Në përgjigje të kësaj shkrese, shoqëria "SLR Albania" sh.p.k., me shkresën e datës 9.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2536/1 prot., datë 14.10.2025, ka bërë me dije se: "Shoqëria 'SLR Albania' sh.p.k. është pajisur me lejen e ndërtimit nr. 505/10, datë 8.9.2025, miratuar me vendimin nr. 45, datë 24.12.2024 të KKT-së. Sipas pikës 2, të nenit 9, të kontratës së nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të vendosë në punë objektin, brenda 12 muajve nga pajisja me lejet dhe në këto kushte është brenda afatit të përcaktuar në kontratë". Gjithashtu, shoqëria ka deklaruar se sipas njoftimit të punimeve të datës 10.9.2025, puna ka filluar më datë 15.9.2025.

- Referuar afateve të përcaktuara në vendim, vërehet se, bazuar në kontratën e nënshkruar mes shoqërisë "SLR Albania" sh.p.k. dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 114 rep., nr. 73 kol., datë 31.1.2024, "Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria 'SLR Albania" sh.p.k.", Mbajtësi i miratimit për ndërtim merr përsipër të vërë në punë centralin fotovoltaik, brenda 12 muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, siç është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në aneksin 2, bashkëlidhur kontratës. Afati për pajisjen me lejet e nevojshme, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga strukturat shtetërore, është jo më shumë se 9 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

- Në vijim, me shkresat nr. 1 dhe 2 prot., datë 6.1.2026, protokolluar në ERE me nr. 36 prot., dhe nr. 40 prot., datë 7.1.2026, shoqëria "SLR Albania" sh.p.k. ka paraqitur raportimin e saj mujor dhe vjetor mbi sasinë e energjisë elektrike të prodhuar, ku rezulton se centrali ka hyrë në prodhim gjatë muajit dhjetor 2025, duke gjeneruar sasinë prej 115850 kwh ose 115.85 mwh.

- Deklarimi i bërë nga shoqëria "SLR Albania" sh.p.k. rezulton në përputhje edhe me raportimin paraprak të shoqërisë "OSSH" sh.a. mbi prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë, të lidhura në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në kushtet kur subjekti njofton se është pajisur me leje ndërtimi më datë 10.9.2025 dhe afati i kësaj leje është për një periudhë 12-mujore, si dhe rezulton se ka filluar ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike në muajin dhjetor 2025, atëherë vlerësohet se pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 262, datë 2.12.2024, i ndryshuar, duhet të shfuqizohet.

- Me shfuqizimin e pikës 3 të këtij vendimi, lind nevoja për shfuqizimin edhe të pikës 4 të tij, pasi kushtet e vendosura në pikat 2 dhe 3, të vendimit nr. 262/2024, të ndryshuar, janë plotësuar.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Bazuar në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ku përcaktohet se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ

tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj, vlerësohet që duhet të shfuqizohen pikat 3 dhe 4, të vendimit të ERE-s nr. 262, datë 2.12.2024, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 3 dhe 4, të vendimit të ERE-s nr. 262, datë 2.12.2024, të ndryshuar, shfuqizohen.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë "SLR Albania" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, "OSSH" sh.a., "FTL" sh.a dhe "ALPEX" sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 14, datë 15.1.2026

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 40, DATË 14.2.2025, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'EB ENERGY' SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 168 prot., datë 14.1.2026, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, 'Mbi licencimin e shoqërisë shoqërinë 'EB Energy' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike"',

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "EB Energy" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 40, datë 14.2.2025, ka licencuar shoqërinë "EB Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

- Në kuptim të pikës 3, të vendimit nr. 40/2025, përcaktohet se: "Shoqëria duhet të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 5.12.2025."

- Referuar pikës 4, të vendimit nr. 40/2025, përcaktohet se: "Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.".

- Gjithashtu, në pikën 5, të vendimit nr. 40/2025, të ndryshuar me vendimin nr. 268, datë 27.10.2025, përcaktohet se: "Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në kuadër të plotësimit të pikës 3 të këtij vendimi.".

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria "EB Energy" sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2451 prot., datë 12.9.2025, ka njoftuar për përfundimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik dhe ka depozituar procesverbalin përkatës të përfundimit të punimeve.

- Me shkresën nr. 2546 prot., datë 30.9.2025, shoqëria ka njoftuar se është në pritje të testimeve dhe certifikimit të veprës nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe lidhjes së kontratës me Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL). Në vijim me shkresën e datës 22.12.2025, shoqëria ka kërkuar rishikimin e afatit të përcaktuar në pikën 3, të vendimit nr. 40/2025, duke sqaruar se mosfillimi i operimit deri më 5.12.2025 ka ardhur për shkaqe procedurale dhe administrative që lidhen me energjizimin dhe formalizimin e kontratave. Gjithashtu, me shkresën nr. 3120/2 prot., datë 30.12.2025, shoqëria ka depozituar procesverbalin e provës 72-orëshe të realizuar më datë 25.11.2025, si

dhe njoftimet për përfundimin e punimeve dhe testimin e veprës drejtuar MIE-s dhe AKBN-së.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Nga dokumentacioni i depozituar rezulton se shoqëria ka përfunduar ndërtimin e centralit dhe ka realizuar testimin 72-orësh brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të vendimit nr. 40/2025.

- Mosenergjizimi përfundimtar i veprës ka ardhur për shkak të kufizimit formal të lidhur me datën fikse të fillimit të operimit të përcaktuar në vendimin e ERE-s.

- Në kushtet kur shoqëria ka përmbushur detyrimet kryesore teknike dhe procedurale për ndërtimin dhe testimin e veprës, vlerësohet se afati për fillimin e operimit duhet të përshtatet me situatën faktike.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pika 3, e vendimit nr. 40/2025, i ndryshuar, duhet të ndryshohet si vijon: "Shoqëria duhet të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.".

- Me ndryshimin e pikës 3 të këtij vendimi lind nevoja për riformulimin edhe të pikës 5 të tij, duke e lidhur atë edhe me kushtin e testimit të veprës sipas pikës 4. Për rrjedhojë, vlerësohet ndryshimi i pikës 5, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, i ndryshuar, si më poshtë vijon: "Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, i ndryshuar, si vijon:

a) Pika 3 ndryshon dhe bëhet:

"Shoqëria duhet të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.";

b) Pika 5 ndryshon dhe bëhet:

"Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.".

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë "EB Energy" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, "OSSH" sh.a., "FTL" sh.a. dhe "ALPEX" sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 15, datë 15.1.2026

MBI PËRCAKTIMIN E VLERËS SË DETYRIMIT PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATËS SË GARANCISË SË ORIGJINËS PËR VITIN 2026

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; të nenit 21, të "Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi

shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 167 prot., datë 14.1.2026, "Mbi përcaktimin e vlerës së detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026",

konstatoi se:

- Në mbështetje të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" dhe të "Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024, ERE ushtron funksionin e organit lëshues të garancive të origjinës dhe, në këtë cilësi, transferon kostot e administrimit të regjistrit elektronik të garancive të origjinës tek mbajtësit e certifikatave, përmes një tarife vjetore për njësi, e cila miratohet çdo vit nga Bordi i ERE-s jo më vonë se data 31 janar.

- ERE është pjesë e sistemit rajonal të Komunitetit të Energjisë për garancitë e origjinës dhe ushtron funksionet e organit lëshues përmes regjistrit elektronik të garancive të origjinës, i cili është krijuar dhe mirëmbahet nga ofruesi i përzgjedhur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, aktualisht *European Energy Exchange AG* (ish-*Grexel Ltd*); njëkohësisht, ERE është anëtare e Shoqatës së Organeve Lëshuese (AIB), e cila administron Sistemin Evropian të Certifikatave të Energjisë (EECS), duke siguruar përputhshmërinë dhe njohjen ndërkombëtare të garancive të origjinës të lëshuara në Republikën e Shqipërisë.

- Në kushtet kur gjatë viteve 2024–2025, ERE ka mbuluar kostot e funksionimit të regjistrit elektronik të garancive të origjinës dhe anëtarësimit në AIB, si dhe duke pasur parasysh mungesën e kërkesave për lëshimin e garancive të origjinës gjatë vitit 2025, për shkak të kushteve të tregut dhe mungesës së njohjes së tyre në BE, në zbatim të nenit 21, pika 6 të rregullores, diferencat e krijuara do të reflektohen dhe korrigjohen në përcaktimin e detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026.

- Referuar raportimeve të Sektorit të Ekonomisë dhe Financës, ERE ka kryer, gjatë viteve të mëparshme dhe ka planifikuar për vitin 2026, pagesat e nevojshme ndaj ofruesit të regjistrit elektronik të garancive të origjinës dhe Shoqatës së Organeve Lëshuese (AIB), në funksion të administrimit të sistemit të garancive të origjinës, dhe këto shpenzime përbëjnë bazën e kostos që merret në konsideratë për përcaktimin e detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026.

- Sasia e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë elektrike gjatë vitit 2025, bazuar në të dhënat paraprake të operatorëve të rrjetit, përllogaritet të jetë rreth 8 milion mwh. Për efekt të përcaktimit të vlerës së detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026, do të llogaritet bazuar në 50% të sasisë së lartpërmendur ose 4 milionë mwh.

- Në bazë të të dhënave të operatorëve të rrjetit për prodhimin nga burimet e rinovueshme gjatë vitit 2025, dhe në zbatim të nenit 21, të "Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", është përcaktuar sasia e energjisë që merret në konsideratë për llogaritjen e detyrimit për vitin 2026, duke reflektuar qasjen e parashikuar në rregullore dhe kushtet aktuale të tregut.

- Vlera e detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026 është përllogaritur në përputhje me nenin 21, të rregullores, bazuar në kostot e administrimit të sistemit dhe sasinë e energjisë të marrë në konsideratë për lëshimin e garancive të origjinës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës së detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026, prej 0.03 euro/mwh.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 48/7, datë 2.2.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Zgjerim i segmentit rrugor dalje Elbasan–Përrenjas–Qafëthanë, faza II'".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "arë" dhe "kullotë", bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", si dhe për pasuritë e llojit "ndërtesë", bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është prej 44,281,610.2 (dyzet e katër milionë e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dhjetë pikë dy) lekësh.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR DALJE ELBASAN–PËRRENJAS–QAFËTHANË

Nr.	Pronari					Të dhëna (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				Vlerësimet për shpronësim sipas llojit "arë"			Vlerësimet për shpronësim sipas llojit "truall"			Vlerësimet për objektet e banimit			Preventivi	Vlera totale	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa e pasurisë	Rrethi	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (leke)			
1	Qemal	Mustafa	Tola	Mirakë	Librazhd	2696	150	Arë	1985	585	174	101790			0					101790.0	Konfirmuar
2	Kujtim	Fejzulla	Tota	Mirakë	Librazhd	2696	159	Arë	1000	872	174	151728			0					151728.0	Konfirmuar
3	Sherif	Sali	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	161	Arë	1000	841	174	146334			0					146334.0	Konfirmuar
4	Mane	Halil	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	166/2	Arë	500	391	174	68034			0					68034.0	Konfirmuar
5	Durim	HALIL	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	166/3	Arë	500	408	174	70992			0					70992.0	Konfirmuar
6	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	166/4	Arë	380	8	0	0			0					0.0	Konfirmuar
7	Isuf	Mustafa	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	168	Arë	900	900	174	156600			0					156600.0	Konfirmuar
8	Qemal	Mustafa	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	167	Arë	1000	617	174	107358			0					107358.0	Konfirmuar
9	Mereme Fatmira Artur Ismet Arjeta	Hajdar Rrapush Rrapush Rrapush Rrapush	Terziu Duka Terziu Terziu Alla	Mirakë	Librazhd	2696	127	Arë	1236	920	174	160080			0					160080.0	Konfirmuar
10	Mustafa	Selim	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	172	Arë	900	900	174	156600			0					156600.0	Konfirmuar
11	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	182	Pyll	68418	12812	0	0			0					0.0	Konfirmuar
12	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	175	Ledh	2881	416	0	0			0					0.0	Konfirmuar
13	Durim Mane Altin Syrja	Halil Halil Halil Halil	Terziu Terziu Terziu Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	166/1	Arë	663	188	174	32712			0					32712.0	Konfirmuar
14	Shtet			Mirakë	Librazhd	2696	114	Rrugë	500	187	0	0			0					0.0	Konfirmuar
15	Shtet			Mirakë	Librazhd	2696	155	Ledh	381	120	0	0			0					0.0	Konfirmuar
16	Shtet			Mirakë	Librazhd	2696	171	Ledh	2068	150	0	0			0					0.0	Konfirmuar
17	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1509	Ledh	458	287	0	0			0					0.0	Konfirmuar
18	Faik Hazit Astrit Kasem Albert Besim	Kasem Halil Faik Faik Faik Faik	Tola Tola Tola Tola Tola Tola	Mirakë	Librazhd	2696	1529	Arë	474	372	174	64728			0					64728.0	Konfirmuar
19	Sami	Shaban	Hoxha	Mirakë	Librazhd	2696	1518	Arë	350	350	174	60900			0					60900.0	Konfirmuar
20	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1500	Ledh	1625	466	0	0			0					0.0	Konfirmuar
21	Sami	Islam	Tola	Mirakë	Librazhd	2696	1449	Arë	1180	35	174	6090			0					6090.0	Konfirmuar
22	Kasem Astrit	Faik Faik	Tola Tola	Mirakë	Librazhd	2696	1534/1	Arë+truall	1562 (Tr.239.8m²+ND.239.8m²)	1068.2	174	185866.8	239.8	240	57552	314.6	28600	8997560	10362505.94	19603484.7	Obj. me leje legalizimi 2 kat, kati përdhe 239.8m²,kati 1 314.6m²
23	Sami	Shaban	Hoxha	Mirakë	Librazhd	2696	1519	Arë	413	413	174	71862			0					71862.0	Konfirmuar
24	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1523	Ledh	202	95	0	0			0					0.0	Konfirmuar
25	Sami	Shaban	Hoxha	Mirakë	Librazhd	2696	1526	Arë	525	407	174	70818			0					70818.0	Konfirmuar
26	Xhemal	Murat	Tola	Mirakë	Librazhd	2696	1505	Arë	1566	1364	174	237336			0					237336.0	Konfirmuar
27	Xheladin	Muhamet	Tola	Mirakë	Librazhd	2696	1513	Arë	595	550	174	95700			0					95700.0	Konfirmuar
28	Muhamet	Rrapush	Tola	Mirakë	Librazhd	2696	1493	Arë	825	726	174	126324			0					126324.0	Konfirmuar
29	Isuf	Islam	Tola	Mirakë	Librazhd	2696	1475	Arë	878	739	174	128586			0					128586.0	Konfirmuar
30	Musa	Islam	Tola	Mirakë	Librazhd	2696	1468	Arë	1665	1665	174	289710			0					289710.0	Konfirmuar
31	Bashkia Librazhd			Mirakë	Librazhd	2696	1342/3	Kullotë	3935	1313	0	0			0					0.0	Konfirmuar
32	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1427	Ledh	735	22	0	0			0					0.0	Konfirmuar
33	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1394	Ledh	847	10	0	0			0					0.0	Konfirmuar
34	Kujtim	Fejzulla	Tola	Mirakë	Librazhd	2696	1316	Arë	800	647	174	112578			0					112578.0	Konfirmuar
35	Bajram Skënder Lumturije	Hasan Hasan Hasan	Tola Tola Bica	Mirakë	Librazhd	2696	1308	Arë	172	159	174	27666			0					27666.0	Konfirmuar
36	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1293	Arë	620	443	0	0			0					0.0	Konfirmuar

37	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1278	Truall	1126	674	0	0			0					0.0	Konfirmuar
38	Ismail	Hysen	Lleshi	Mirakë	Librazhd	2696	1225/1	Arë	138	118	174	20532			0					20532.0	Konfirmuar
39	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1230	Arë	860	431	0	0			0					0.0	Konfirmuar
40	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1200	Ledh	2576	1436	0	0			0					0.0	Konfirmuar
41	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1155	Rrugë	581	411	0	0			0					0.0	Konfirmuar
42	Jaho	Jaho	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1145	Arë	127	105	174	18270			0					18270.0	Konfirmuar
43	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1133	Kullotë	1025	663	0	0			0					0.0	Konfirmuar
44	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	65	Hekurudhë	61445	613	0	0			0					0.0	Konfirmuar
45	Hasan	Islam	Lleshi	Mirakë	Librazhd	2696	1137	Arë	942	417	174	72558			0					72558.0	Konfirmuar
46	Fadile	Ramazan	Xhyra	Mirakë	Librazhd	2696	1125	Arë	560	560	174	97440			0					97440.0	Konfirmuar
	Hanife	Ramazan	Koçi																		
	Lavdie	Ramazan	Mema																		
	Vera	Ramazan	Goma																		
	Salushe	Hamit	Lleshi																		
	Drilona	Xhemal	Ajdini																		
	Ermir	Xhemal	Lleshi																		
	Florene	Xhemal	Lleshi																		
47	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1152	Kullotë	6640	4077	0	0			0					0.0	Konfirmuar
48	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1041	Shkëmbore	4660	1425	0	0			0					0.0	Konfirmuar
49	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1804	Lumë	151057	637	0	0			0					0.0	Konfirmuar
50	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	2353/1	Truall	28266	25856	0	0			0					0.0	Konfirmuar
51	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1400	Rrugë	4738	2592	0	0			0					0.0	Konfirmuar
52	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1312	Ledh	708	707	0	0			0					0.0	Konfirmuar
53	Shyqyri	Mustafa	Tola	Mirakë	Librazhd	2696	1294	Arë	866	255	174	44370			0					44370.0	Konfirmuar
54	Bajram	Hasan	Tola	Mirakë	Librazhd	2696	1291	Arë	562	502	174	87348			0					87348.0	Konfirmuar
	Skënder	Hasan	Tola																		
	Lumturije	Hasan	Bica																		
55	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1284	Rrugë	2235	256	0	0			0					0.0	Konfirmuar
56	Valentina	Hasan	Lleshi	Mirakë	Librazhd	2696	1266	Arë+truall	2299 (Tr.300m²+ND.127m²)	1999	174	347826	300	240	72000	127	28600	3632200		4052026.0	Konfirmuar
	Floresha	Hasan	Dobra																		
	Xhemile	Sami	Lleshi																		
	Shpresa	Dashnor	Hoxha																		
	Esmeralda	Dashnor	Lleshi																		
	Mariglen	Dashnor	Lleshi																		
	Marjus	Ndrieim	Hoxholli																		
57	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1205	Ledh	931	228	0	0			0					0.0	Konfirmuar
58	Ardian	Ramazan	Lleshi	Mirakë	Librazhd	2696	1239	Arë	800	743	174	129282			0					129282.0	Konfirmuar
	Xhemal	Ramazan	Lleshi																		
59	Ismail	Hysen	Lleshi	Mirakë	Librazhd	2696	1225/4	Arë	422	701	174	121974			0					121974.0	Konfirmuar
60	Ismail	Hysen	Lleshi	Mirakë	Librazhd	2696	1225/3	Arë	421	416	174	72384			0					72384.0	Konfirmuar
61	Ismail	Hysen	Lleshi	Mirakë	Librazhd	2696	1225/2	Arë	421	315	174	54810			0					54810.0	Konfirmuar
62	Mane	Halil	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1185/1	Arë	267	206	174	35844			0					35844.0	Konfirmuar
63	Durim	Halil	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1185/2	Arë	267	194	174	33756			0					33756.0	Konfirmuar
64	Syrja	Halil	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1185/3	Arë	267	267	174	46458			0					46458.0	Konfirmuar
65	Altin	Halil	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1185/4	Arë	267	244	174	42456			0					42456.0	Konfirmuar
66	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1181	Rrugë	1234	853	0	0			0					0.0	Konfirmuar
67	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1175	Rrugë	898	539	0	0			0					0.0	Konfirmuar
68	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1022	Përrua	24129	1461	0	0			0					0.0	Konfirmuar
69	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1140	Kullotë	396	244	0	0			0					0.0	Konfirmuar
70	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1151	Ledh	825	155	0	0			0					0.0	Konfirmuar
71	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1127	Rrugë	277	255	0	0			0					0.0	Konfirmuar
72	Jaho	Jaho	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1114	Arë	277	277	174	48198			0					48198.0	Konfirmuar
73	Republika E Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1102	Kullotë	669	669	0	0			0					0.0	Konfirmuar
74	Republika E Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1083	Ledh	1462	1251	0	0			0					0.0	Konfirmuar
75	Shtet			Mirakë	Librazhd	2696	915	Pyll	3574339	224	0	0			0					0.0	Konfirmuar
76	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1057	Rrugë	3359	25	0	0			0					0.0	Konfirmuar
77	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	964	Shkëmbore	63557	5977	0	0			0					0.0	Konfirmuar
78	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1726	Ledh	5795	12	0	0			0					0.0	Konfirmuar
79	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1728	Ledh	431	20	0	0			0					0.0	Konfirmuar
80	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1752	Rrugë	1869	166	0	0			0					0.0	Konfirmuar
81	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1729	Ledh	849	600	0	0			0					0.0	Konfirmuar
82	Ramazan	Ali	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1732	Arë	345	14	174	2436			0					2436.0	Konfirmuar
83	Beqir	Kasem	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1738	Arë	394	60	174	10440			0					10440.0	Konfirmuar
84	Isuf	Kasem	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1740	Arë	394	112	174	19488			0					19488.0	Konfirmuar
85	Shefqet	Kasem	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1742	Arë	674	222	174	38628			0					38628.0	Konfirmuar
86	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1733	Ledh	581	175	0	0			0					0.0	Konfirmuar
87	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1743	Ledh	372	57	0	0			0					0.0	Konfirmuar
88	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1748	Arë	611	29	0	0			0					0.0	Konfirmuar
89	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1751	Arë	395	32	0	0			0					0.0	Konfirmuar
90	Jaho	Xhemal	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1753	Arë	4797	414	174	72036			0					72036.0	Konfirmuar
91	Korridori 8			Mirakë	Librazhd	2696	1754	Arë	2291	238	174	41412			0					41412.0	Konfirmuar
92	Hysen	Xhemal	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1759	Arë	2557	127	174	22098			0					22098.0	Konfirmuar
93	Korridori 8			Mirakë	Librazhd	2696	1756	Arë	3600	19	174	3306			0					3306.0	Konfirmuar
94	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1762	Ledh	262	127	0	0			0					0.0	Konfirmuar
95	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1770	Ranishte	8794	2237	0	0			0					0.0	Konfirmuar
96	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	914	Rrugë	2235	2917	0	0			0					0.0	Konfirmuar
97	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1785	Ranishte	2138	1111	0	0			0					0.0	Konfirmuar
98	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	927	Shkëmbore	35925	321	0	0			0					0.0	Konfirmuar
99	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1776	Kullotë	4310	526	0	0			0					0.0	Konfirmuar
100	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1866	Ranishte	2423	1588	0	0			0					0.0	Konfirmuar
101	Republika E Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1878	Përrua	619	229	0	0			0					0.0	Konfirmuar
102	Shefqet	Kasem	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1907	Arë	1748	315	174	54810			0					54810.0	Konfirmuar
103	Xhemal	Ali	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1927	Arë	1200	701	174	121974			0					121974.0	Konfirmuar
104	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1901	Ledh	351	70	0	0			0					0.0	Konfirmuar
105	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1934	Arë	284	233	0	0			0					0.0	Konfirmuar
106	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1937	Arë	181	166	0	0			0					0.0	Konfirmuar

107	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1939	Arë	101	101	0	0			0					0.0	Konfirmuar
108	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1905	Truall	3181	556	0	0			0					0.0	Konfirmuar
109	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1960	Rrugë	1172	628	0	0			0					0.0	Konfirmuar
110	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1755	Rrugë	16415	4513	0	0			0					0.0	Konfirmuar
111	Shefqet	Kasem	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	2032	Arë	880	798	174	138852			0					138852.0	Konfirmuar
112	Ismail	Terziu		Mirakë	Librazhd	2696	2006	Arë	475	379	174	65946			0					65946.0	Konfirmuar
113	Besim	Hasan	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1969	Arë	616	447	174	77778			0					77778.0	Konfirmuar
114	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1938	Arë	741	610	0	0			0					0.0	Konfirmuar
115	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1919	Kullotë	526	181	0	0			0					0.0	Konfirmuar
116	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1902	Rrugë	213	138	0	0			0					0.0	Konfirmuar
117	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	1889	Kullotë	1705	478	0	0			0					0.0	Konfirmuar
118	Hysen	Xhaferr	Mjeshtri	Mirakë	Librazhd	2696	2225	Arë	1188	385	174	66990			0					66990.0	Konfirmuar
119	Ismail	Rrapush	Mjeshtri	Mirakë	Librazhd	2696	2221	Arë	1985	351	174	61074			0					61074.0	Konfirmuar
120	Mehmet	Jonuz	Mjeshtri	Mirakë	Librazhd	2696	2220	Arë	895	128	174	22272			0					22272.0	Konfirmuar
121	Sanije	Sherif	Koçi	Mirakë	Librazhd	2696	2192	Arë	4361	484	174	84216			0					84216.0	Konfirmuar
122	Ibrahim	Osman	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	2198	Arë	610	134	174	23316			0					23316.0	Konfirmuar
123	Jaho	Osman	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	2174	Arë	1052	128	174	22272			0					22272.0	Konfirmuar
124	Besim	Hasan	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	2193	Arë	1006	121	174	21054			0					21054.0	Konfirmuar
125	Fadil	Hasan	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	2184	Arë	1344	173	174	30102			0					30102.0	Konfirmuar
126	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	2183	Arë	717	107	0	0			0					0.0	Konfirmuar
127	Hysen	Jonuz	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	2179	Arë	1581	284	174	49416			0					49416.0	Konfirmuar
128	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	2181	Arë	2247	344	0	0			0					0.0	Konfirmuar
129	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	2171	Përrua	1122	117	0	0			0					0.0	Konfirmuar
130	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	2169	Arë	273	107	0	0			0					0.0	Konfirmuar
131	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	2163	Arë	163	67	0	0			0					0.0	Konfirmuar
132	Feride	Abdulla	Koçi	Mirakë	Librazhd	2696	2167	Arë	505	112	174	19488			0					19488.0	Konfirmuar
	Arif	Sherif	Koçi																		
	Sanie	Sherif	Hoxha																		
	Xhevrije	Sherif	Tola																		
	Jaho	Sherif	Koçi																		
133	Hekuran	Sulejman	Koçi	Mirakë	Librazhd	2696	2165	Arë	517	113	174	19662			0					19662.0	Konfirmuar
134	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	2156	Arë	514	132	0	0			0					0.0	Konfirmuar
135	Bp Koci, Xhevrie Tola, Sanie Hoxha			Mirakë	Librazhd	2696	2160	Arë	426	139	174	24186			0					24186.0	Konfirmuar
136	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	2151	Arë	222	77	0	0			0					0.0	Poseduar nga Arif Sherif Koçi
137	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	2148	Kullotë	9545	1897	0	0			0					0.0	Konfirmuar
138	Sabire	Ismail	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	2113	Arë	3825	1594	174	277356			0					277356.0	Konfirmuar
	Fadile	Beqir	Jaupbashi																		
	Vefa	Beqir	Terziu																		
	Sulajman	Beqir	Terziu																		
	Fatbardha	Beqir	Ruçi																		
	Alma	Beqir	Sina																		
	Trane	Sherif	Terziu																		
139	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	2063	Pyll	487	196	0	0			0					0.0	Konfirmuar
140	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	2074	Kanal	184	90	0	0			0					0.0	Konfirmuar
141	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	492	Përrua	147	17.92	0	0			0					0.0	Konfirmuar
142	Gega-G SHPK			Mirakë	Librazhd	2696	1079/1	Truall	182.3				182.3	240	43752					43752.0	Konfirmuar
143	Gega-G SHPK			Mirakë	Librazhd	2696	1079/1-N	Ndërtesë	120.7										1197702.49	1197702.5	Konfirmuar
144	Haziz	Sadik	Alla	Mirakë	Librazhd	2696	1079/5	Truall	500 (ND.211.1m²)				500	240	120000	395.28			5240528	5360528.0	Konfirmuar
145	Xhemal	Ali	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	2076/4	Truall	100 (ND.60m²)				100	240	24000	130			9148997	9172997.0	Obj. 2 kat, k. përdhe 60m² pikë servis, k. parë 70m² dyqan lubrifikantësh.
146	Republika e Shqipërisë			Mirakë	Librazhd	2696	494	Ledh	59	6.7	0	0			0					0.0	Konfirmuar
147	Halil	Islam	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	1164	Arë	310	278	174	48372								48372.0	Konfirmuar
148	Shefqet	Kasem	Terziu	Mirakë	Librazhd	2696	2092	Arë	241	241	174	41934			0					41934.0	Konfirmuar
	Shuma																			**44281610.2**	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2026/02/09 15:08:32 +02'00'
3c83804931ad4a71b7ae597da31105b

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)